# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5493
E hënë, 4 qershor 2018
çmimi 0.40 €

## Programeve ekzistuese u vazhdohet akreditimi edhe për një vit

FAQE 5



Agjencia e Akreditimit e Kosovës ka vendosur të zgjasë edhe për një vit të gjitha akreditimet e programeve ekzistuese, ndërsa këtë vit nuk do të bëhet akreditimi i programeve të reja

Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", ZENUN PAJAZITI FAQE 4-5



# Udhëheqja e dialogut nga presidenti, lehtësim për procesin

Deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Zenun Pajaziti, ka bërë me dije se pozita dhe opozita duhet të ndihen të çliruar për faktin se presidenti Hashim Thaçi do ta udhëheqë fazën finale të dialogut me Serbinë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re" ai ka thënë se përfshirja e presidentit në këtë fazë të dialogut do të jetë lehtësim për këtë proces. Sipas tij, përfshirja e institucioneve të vendit në këtë proces të dialogut është më e rëndësishme se emrat. Deputeti i PDK-së ka deklaruar se ata që kundërshtojnë që presidenti i vendit të jetë në krye të këtij procesi e bëjnë për çështje personale. Pajaziti është shprehur i sigurt se në Kuvend do të mbizotërojnë zërat që kanë në plan të parë interesin e shtetit tonë në këtë proces të dialogut

## Kurti: Gjendja në Telekom si pasojë e krimit të organizuar

Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, në një konferencë për medie mbajtur të dielën, në të cilën ka folur për zgjidhjen në Telekomin e Kosovës pas gjendjes së rënduar, ka thënë se gjendja në këtë ndërmarrje është si pasojë e krimit që është bërë në të. Ndërkaq Ismet Hamiti, njohës i telekomunikacionit, ka thënë se Telekomin e Kosovës mund ta shpëtojë Prokuroria e Shtetit

FAQE 8






## Veseli: Liberalizimi nuk duhet të shihet si mundësi për t'u larguar nga Kosova

Deri në fund të këtij viti Kosova do ta ketë liberalizimin e vizave pasi ka përmbushur kriteret e nevojshme, por liberalizimi nuk duhet të shihet si mundësi nga të rinjtë për t'u larguar nga Kosova. Kështu ka deklaruar të dielën lideri i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kadri Veseli, i cili ka thënë se e ardhmja e sigurt e të gjithë qytetarëve është në Republikën e Kosovës FAQE 3

## AKTUALE



LDK-JA, KJO PARTI OPORTUNISTE, KLIENTELISTE DHE PA KURRIZ TË QËNDRUESHËM POLITIK F. 11

BEHXHET SH. SHALA - BAJGORA

HARADINAJ: PAJTIMI ME SERBINË, VETËM NË KËMBIM TË NJOHJES F. 6

LUGINA E PRESHEVËS, E PAKËNAQUR ME PËRKRAHJEN E KOSOVËS DHE TË SHQIPËRISË F. 11

## EKONOMI

SEKTORI BANKAR PËR TRE MUAJ ME FITIM PREJ 17.9 MILIONË EUROSH F. 9

NESËR TË RINJTË MUND T'I SHPALOSIN IDETË E TYRE INOVATIVE F. 9

## KULTURË

PROMOVOHET LIBRI ME POEZI I ERJON HADERGJONAJT 'NË ISHULLIN E ËNDRRAVE' F. 18

## SPORT

REXHA: MARRËVESHJE NUK KAM ME ASNJË SKUADËR, BISEDIME PO F. 18

RENOVA PUTZ
Maqedoni Xhepcisht –Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009 +389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
PRINCESHA GROUP SH.P.K.
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

SatStyro
Mushnikovë-Prizren-Kosovë
SatStyro
Product of EPS and XPS
Mob.: +377(0) 44 506 815
Tel&Fax.: +381(0) 29 246 030
e-mail: sat_styro@yahoo.com
www.satstyro.com

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

## Protesta anti-qeveritare në Maqedoni



**Shkup, 3 qershor** - Mijëra mbështetës të opozitës kanë protestuar para objektit të Qeverisë së Maqedonisë në Shkup, duke thirrur për zgjedhje të parakohshme.
Partia VMRO-DPMNE që ka udhëhequr vendin nga viti 2006-2017 ka organizuar protesta masive anti-qeveritare, duke kërkuar që zgjedhjet të mbahen në mars ose prill të vitit të ardhshëm.
Kryeministri Zoran Zaev mori pushtetin në maj të vitit 2017, rreth 11 vjet të rregullit konservativ në mes të krizës politike që përcolli edhe përgjimin e skandaleve të korrupsionit më 2015.
Opozita thotë se qeveria është e paaftë, e ka shkatërruar ekonominë dhe ka lulëzuar korrupsioni. Po sipas opozitës, qeveria e tanishme ka shkatërruar interesin kombëtar duke negociuar me Greqinë lidhur me kontestin e emrit.

# Rama: Shqipëria meriton hapjen e negociatave

Kryeministri Rama tha se Shqipëria meriton hapjen e negociatave pasi ka marrë një rekomandim shumë të qartë nga Komisioni Evropian. Po ashtu, ai bëri me dije se beson fuqishëm në shpirtin e Evropës, e cila ka një qasje strikte dhe të drejtë



**Tiranë, 3 qershor** - Kryeministri Edi Rama vlerëson mbështetjen e Austrisë në çdo moment kyç që ka kaluar Shqipëria duke e konsideruar si partnere të fortë në rrugën drejt integrimit në BE. Në një intervistë për ARD, Rama deklaron se "Austria është prej shumë kohësh mbështetëse e Ballkanit Perëndimor dhe ka qenë gjithnjë besnike dhe miqësore me ne, si dhe një prej mbështetesve më të mëdha".
I pyetur mbi rezultatin e samitit të fundit të Ballkanit Perëndimor në Sofje dhe nëse priste më shumë rezultate, Rama shprehet: "Jo, nuk prisja, sepse e dija çfarë kishim bërë dhe sa progres mund të bënim, kështu që e dija se nuk ishte koha për të kërkuar asgjë të tillë, por se ishte një çast për të vazhduar dhe luftuar, pra ishte një takim i mirë sepse munda të luftoj".
Për sa i përket hapjes së negociatave, Rama thekson se "Shqipëria e meriton hapjen e negociatave pasi kemi marrë një rekomandim shumë të qartë nga Komisioni". "Nuk e kuptoj se si kjo makineri që kushton miliarda për t'i hartuar raportet e hollësishme mund t'i sfidojë objektivat e veta. Sigurisht, e di që ka vende anëtare që kanë probleme të brendshme, por besoj fuqishëm në shpirtin e Evropës. Dhe në shpirtin e Evropës ka një qasje strikte dhe të drejtë, kështu që deri tani qasja ka qenë strikte dhe shpresoj të mos jetë e padrejtë", tha kryeministri.
Për sa i përket migracionit ilegal që kalon kufirin nga Greqia drejt Shqipërisë dhe më pas drejt Evropës Qendrore, Rama deklaron se "kemi një rritje me 14 herë në raport me vitin e kaluar. Këto shifra nuk janë shqetësuese për gjithë Evropën, por mund të bëhen shqetësuese. Pra, ne nuk duhet të bëjmë atë që është bërë gabim në vitin 2015. Duhet të jemi parandalues dhe proaktivë. Për këtë arsye fola edhe me kancelarin këtu për të ngritur një bashkëpunim që të sigurohemi që gabimi i vitit 2015 të mos përsëritet".
I pyetur nëse duhet të ngrihet një barrierë në kufirin me Greqinë në të ardhmen, kryeministri deklaron se "nuk besoj në barrierat fizike. Besoj në barrierën e bashkëpunimit mes shteteve dhe njerëzve. Pra, nëse kjo barrierë është e ndërthurur mirë, atëherë çdo gjë është shumë mirë dhe nëse është e bërë siç duhet, jo vetëm mbron kufijtë, por respekton edhe dinjitetin e njerëzve", tha Rama.

# Vuçiçi ka refuzuar 'planin amerikan' për Kosovën

**Beograd, 3 qershor** - Presidenti serb Aleksandar Vuçiq ka hedhur poshtë një dokument pune lidhur me zgjidhjen e çështjes së Kosovës, i njohur si "paketa amerikane". Sipas gazetës "Vecernje Novosti", Vuçiqi e ka vlerësuar këtë dokument të padenjë dhe të papranueshëm për Serbinë dhe të njëjtin nuk ka dashur as ta nxjerrë në opinion.
"Ekzistencën e këtij dokumenti 'non paper", i cila u dërgua së fundmi përmes kanaleve diplomatike joformale në Presidencën e Serbisë, u konfirmua të shtunën edhe nga zëvendëskryeministri i Kosovës, Enver Hoxhaj, duke shpresuar se Beogradi do të pranojë atë letër, e cila kërkon që në mënyrë indirekte, por praktike, Serbia ta njohë Kosovën", shkruan gazeta serbe. "Përfaqësuesve të Kosovës dhe Serbisë u janë prezantuar katër shtylla të marrëveshjes historike, kurse nga Prishtina kanë mbërritur zërat se zgjidhja e çështjeve të hapura bilaterale mes dy vendeve është



njohja reciproke, dhe se pikërisht kjo është në letrën, të cilën e ka në duar Beogradi", shkruan tutje.
Gazeta serbe pretendon se i ka siguruar katër pikat e "pakos amerikane", të cilat ia ka dorëzuar presidentit serb. "Asociacioni i komunave serbe merr fuqi të gjera ekzekutive dhe kompetenca të zgjeruara në fushën e shëndetësisë, arsimit dhe kulturës. Asociacioni do të ishte i lidhur ngushtë me zëvendëskryeministrin e Kosovës, që do të ishte nga radhët e komunitetit serb, e që do të ishte kontrollues i këtij bashkësie", janë dy pikat e para, ashtu siç ka shkruar gazeta serbe.
Më tej thuhet se Serbia nuk duhet ta pengojë rrugën e Kosovës në anëtarësimin në organizatat ndërkombëtare. "Beogradi duhet të mundësojë që Kosova të bëhet pjesë e organizatave ndërkombëtare dhe OKB-së. Në qoftë se Serbia bie dakord me këtë paketë, do të ishte në gjendje të hyjë në BE dhe ShBA-ja do të mbështeste në aspektin ekonomik dhe politikën ndërkombëtare", thuhet në dy pikat e tjera.

## Frontex-i shton rojet në kufirin greko-shqiptar



**Bruksel, 3 qershor** - Kreu i Agjencisë Evropiane për Ruajtjen e Kufijve (Frontex) ka njoftuar se jo vetëm që ekziston një korridor i ri ballkanik, të cilin e ndjekin refugjatët që vijnë nga Turqia dhe pjesë e të cilit është edhe Shqipëria, por edhe se numri i këtyre refugjatëve është rritur ndjeshëm muajt e fundit.
Sipas kësaj agjencie, Greqia po përballon sfida të mëdha në këtë drejtim.
Frontex-i ka njoftuar se është duke u përpjekur ta mbështesë Greqinë përgjatë brigjeve të Egjeut Verior, me asistencë teknike, por edhe me mjete në kufirin tokësor me Turqinë në Evropë. Muajt e fundit disa shtete të Ballkanit Perëndimor, si Kroacia dhe Sllovenia, kanë protestuar duke parë numrin e madh të refugjatëve dhe emigrantëve të paligjshëm që kanë hyrë nëpërmjet këtij korridori.

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Partia Demokratike e Kosovës (PDK) ka mbajtur Kuvendin Zgjedhor të Rinisë Demokratike në Suharekë, Shtime, Lipjan dhe Viti

# Veseli: Liberalizimi nuk duhet të shihet si mundësi për t'u larguar nga Kosova




**Deri në fund të këtij viti Kosova do ta ketë liberalizimin e vizave pasi ka përmbushur kriteret e nevojshme, por liberalizimi nuk duhet të shihet si mundësi nga të rinjtë për t'u larguar nga Kosova. Kështu ka deklaruar të dielën lideri i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kadri Veseli, i cili ka thënë se e ardhmja e sigurt e të gjithë qytetarëve është në Republikën e Kosovës**

EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 3 QERSHOR - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kadri Veseli, ka bërë me dije se deri në fund të këtij viti Kosova do ta ketë liberalizimin e vizave pasi ka përmbushur kriteret e nevojshme. Por, ai ka kërkuar nga qytetarët që liberalizimin mos ta shohin si mundësi për t'u larguar nga Kosova. "Shumë shpejt, këtë vit, qytetarët e Kosovës do të lëvizin pa viza. Kjo mundësi do të përdoret edhe nga rinia për të dalë e marrë përvoja akademike e shkëmbime kulturore, por assesi askush nga ju të rinj të dashur nuk duhet ta shihni liberalizimin si mundësi për largim. Përkundrazi, e ardhmja e sigurt e juaja dhe e të gjithë qytetarëve është në Republikën e Kosovës", ka deklaruar Veseli të dielën në Kuvendin Zgjedhor të Rinisë Demokratike në Suharekë, ku ishte i shoqëruar edhe nga zëvendëskryetari Enver Hoxhaj, ministri Uran Ismaili, Abelard Tahiri dhe Kujtim Gashi.

Ai ka thënë se "Dekada e Re" bazohet në tri shtylla: besim, zhvillim, integrim. "Pa besuar nuk e kishim arritur as lirinë e as pavarësinë. Dekada e Re është transformim ekonomik i Kosovës. Pra, të keni besim se bashkë mund ta zhvillojmë dhe integrojmë Kosovën", ka theksuar Veseli duke shtuar se angazhimi kaq i madh i të rinjve tregon se Kosova po transformohet në të mirë të qytetarëve. "Angazhimi i mbi 20 mijë të rejave e të rinjve në PDK është një tregues shumë i madh se Kosova po ndryshon dhe do të zhvillohet e transformohet edhe më shumë sepse çdoherë që është mobilizuar e angazhuar kanë ndodhur zhvillime të mira në të mirë të vendit. Rinia gjithmonë do ta ketë vendin kryesor në PDK, sepse të rinjtë janë plot energji e ide inovatore për të ardhmen e vendit", është shprehur Veseli.

Ndërsa zëvendëskryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Enver Hoxhaj, ka thënë se andej nga lëviz kjo parti, lëviz edhe Kosova. "Forca e Kosovës ka qenë gjithmonë rinia. Të gjitha zhvillimet pozitive në Kosovë kanë ndodhur në krye me rininë. Andaj dua t'i ftoj të gjithë të rinjtë që po bëhen pjesë e Dekadës së Re, të përgatiten dhe punojnë për ta forcuar dhe rritur edhe më shumë PDK-në në të gjitha komunat e Kosovës", ka deklaruar Hoxhaj.

Po të dielën PDK-ja ka mbajtur Kuvendin Zgjedhor të Rinisë Demokratike edhe në Komunën e Lipjanit, ku ka marrë pjesë lidershipi i partisë. Me këtë rast lideri i PDK-së, Kadri Veseli, ka thënë se rinia është promotore e transformimit dhe zhvillimit të PDK-së dhe e Kosovës. "Ky është një mesazh i qartë se rinia është e angazhuar fuqishëm dhe do të jetë prijëse e zhvillimeve pozitive në vend. Partia Demokratike e Kosovës ua ka dhënë hapësirën kryesore të rinjve dhe sot shumica e ministrave tanë janë të rinj që janë rritur në Rininë Demokratike", ka theksuar Veseli. Ai treguar se në "Dekadën e Re", pas përmbylljes së shtetndërtimit, fokusi kryesor është zhvillimi ekonomik i Kosovës dhe perspektiva e sigurt për rininë inovatore që ka vullnet dhe energji për punë.

Gjithashtu, Veseli ka qenë ishte i pranishëm edhe në Kuvendin Zgjedhor të Rinisë Demokratike në Shtime, ku ka thënë se që nga themelimi i PDK-së qytetarët e Shtimes i kanë besuar pa rezerva kësaj partie dhe se rinia e kësaj komune gjithmonë ka qenë pjesë e zhvillimeve pozitive në Kosovë.

## Tahiri: Nuk mund të imagjinohet asnjë fitore pa angazhimin e rinisë

Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Kadri Veseli, i shoqëruar edhe nga zyrtarë të lartë partiakë, ka ndjekur nga afër kuvendet zgjedhore të Rinisë Demokratike në Kaçanik e Viti, ku qindra të rinj nga këto komuna janë bërë pjesë e platformës së re të PDK-së për Dekadën e Re.

Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, i cili rrugëtimin politik në PDK e ka filluar si anëtar i Rinisë Demokratike, ka folur para të rinjve vitias për hapësirën që lidershipi i kësaj partie ua krijon të rinjve. "Nuk mund të imagjinohet asnjë zhvillim e fitore pa angazhimin e rinisë. Para 16 vjetëve kam filluar angazhimin tim politik si pjesë e Rinisë Demokratike dhe jam pjekur politikisht në PDK, ndërsa në këtë mandat lidershipi ma ka besuar udhëheqjen e Ministrisë së Drejtësisë. Edhe ju të rinj që tani po filloni angazhimin politik, do ta keni hapësirën e garantuar të veprimit në PDK. Vetëm punoni shumë dhe mos u dorëzoni asnjëherë në sfidat që do t'i keni përpara", ka thënë Tahiri.

Flet për "Epokën e re", Zenun Pajaziti

# Udhëheqja e dialogut nga presidenti,

**Deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Zenun Pajaziti, ka bërë me dije se pozita dhe opozita duhet të ndihen të çliruar për faktin që presidenti Hashim Thaçi do ta udhëheqë fazën finale të dialogut me Serbinë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se përfshirja e presidentit në këtë fazë të dialogut do të jetë lehtësim për këtë proces. Sipas tij, përfshirja e institucioneve të vendit në këtë proces të dialogut është më e rëndësishme se emrat. Deputeti i PDK-së ka deklaruar se ata që kundërshtojnë që presidenti i vendit të jetë në krye të këtij procesi e bëjnë për çështje personale. Pajaziti është shprehur i sigurt se në Kuvend do të mbizotërojnë zërat që kanë në plan të parë interesin e shtetit tonë në këtë proces të dialogut**



EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

**PRISHTINË, 3 QERSHOR** - Deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Zenun Pajaziti, ka deklaruar se udhëheqja e dialogut me Serbinë nga presidenti Hashim Thaçi do të jetë lehtësim për këtë proces. Ai ka bërë me dije se përvoja e presidentit dhe përfshirja e tij nga fillimi në këtë proces do të jetë përparësi për Kosovën në këtë proces. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Pajaziti ka deklaruar se përfshirja e institucioneve në këtë proces është më e rëndësishme sesa emrat. "Kur e dimë se në krye të këtyre institucioneve janë njerëz kredibilë për shkak të kaluarës së tyre dhe për shkak të përfshirjes së tyre në proces, mendoj se kjo jo që nuk prish punë, por është një lehtësim. Ne që merremi me politikë, pozitë dhe opozitë, duhet të ndihemi të çliruar për faktin se njerëzit që udhëheqin institucionet kanë një kredibilitet të mjaftueshëm që të jenë në krye të këtij procesi", ka thënë Pajaziti.

Ai ka vlerësuar se askush nuk duhet të frikësohet nga përfshirja e presidentit në këtë proces. "Nuk duhet të frikësohemi fare për këtë. Përkundrazi, cilido që do të donte të eskivonte nga përgjegjësitë e tij në këtë situatë do të ishte keq. Gatishmëria e përfaqësuesve të institucioneve që të marrin përgjegjësi është një gjë pozitive. Në këtë drejtim pres që edhe politikanët opozitarë të jenë të kyçur në këtë proces. Askush nuk mund të fitojë politikisht nëse mendon se duhet ta kalkulojë partiakisht në këtë proces", është shprehur ai.

Deputeti i PDK-së ka deklaruar se ata që kundërshtojnë që presidenti i vendit të jetë në krye të këtij procesi e bëjnë për çështje personale. "Mendoj se një pjesë e debatit që është zhvilluar deri më tani dhe qëndrimeve që kanë dalë prej disa eksponentëve të partive opozitare, më shumë shprehin atë komunikimin e tyre me elektoratin e vet sesa një qëndrim të pjekur politik me interes nacional të vendit", ka thënë Pajaziti, duke shtuar se në Kuvendin e Kosovës pret një debat konstruktiv për platformën e qeverisë rreth fazës finale të dialogut, e cila pritet të diskutohet sot (e hënë). "Jam i sigurt se në Kuvend do të mbizotërojnë zërat që kanë në plan të parë interesin e shtetit tonë në këtë proces. Pra, do të duhej të dalin përmbi zërat partiakë. Debati për këtë çështje duhet të jetë serioz dhe t'i përvishemi bashkë punës, pozitë dhe opozitë, në këtë proces të cilin duhet ta përmbyllim", ka thënë Pajaziti.

**"Epoka e re":** *Të hënën pritet të diskutohet në Kuvend rreth platformës për fazën finale të dialogut me Serbinë. Cili duhet të jetë qëndrimi i Kuvendit për këtë platformë?*

**Pajaziti:** Nuk mund ta paragjykoj përfundimin e një debati të tillë, por ajo që pres unë dhe besoj shumica e deputetëve është që Kuvendi ta konfirmojë nevojën e domosdoshme të vazhdimit të dialogut, po ashtu ta konfirmoj nevojën e përmbylljes së këtij procesi, duke u angazhuar të gjithë faktorët politikë. Pra, pasi dialogu tashmë nuk kontestohet,

# lehtësim për procesin



duhet të arrijmë të pajtohemi rreth një platforme e cila do të jetë si një udhërrëfyes që do të përdoret nga përfaqësuesit tanë në dialog. Personalisht pres të këtë një pjekuri politike dhe të këtë seriozitet në këtë debat, sepse edhe dialogu është një proces serioz sikurse që është serioze edhe faza në të cilën ndodhemi. Po ashtu, duhet të kuptohet edhe seriozitei i partnerëve ndërkombëtarë që po ndërmjetësojmë për ta mbyllur këtë proces dhe të ecim përpara.

**"Epoka e re":** *Platforma parasheh që udhëheqës i delegacionit të Kosovës të jetë presidenti Hashim Thaçi. Pse këtë proces duhet ta udhëheqë presidenti i vendit?*

**Pajaziti:** Nuk besoj se ka nevojë që tani të merremi me emra të përveçëm. Mendoj se përfshirja e institucioneve në këtë proces është më e rëndësishme se emrat. Por, kur e dimë se në krye të këtyre institucioneve janë njerëz kredibilë për shkak të kaluarës së tyre dhe për shkak të përfshirjes së tyre në proces, mendoj se kjo jo që nuk prish punë, por është një lehtësim. Ne që merremi me politikë, pozitë dhe opozitë, duhet të ndihemi të çliruar për faktin se njerëzit që udhëheqin institucionet kanë një kredibilitet të mjaftueshëm që të jenë në krye të këtij procesi. Nuk duhet të frikësohemi fare për këtë, përkundrazi, cilido që do të donte të eskivonte nga përgjegjësitë e tij në këtë situatë, do të ishte keq. Gatishmëria e përfaqësuesve të institucioneve që të marrin përgjegjësi është një gjë pozitive. Në këtë drejtim pres që edhe politikanët opozitarë të jenë të kyçur në këtë proces. Askush nuk mund të fitojë politikisht nëse mendon se duhet ta kalkuloj partiakisht në këtë proces.

**"Epoka e re":** *Ka subjekte politike edhe brenda koalicionit qeverisës që janë shprehur kundër që z. Thaçi të jetë udhëheqës i këtij dialogu?*

**Pajaziti:** Ne i kemi dëgjuar këto deklarime, por në rast se do të kemi një propozim ndryshe dhe do të mund të ishte serioz për të biseduar, kjo do të ishte diçka tjetër. Por, deri më tani nuk kemi propozim tjetër. Kundërshtimet e tilla kanë të bëjnë më shumë me relacionet personale të disa prej liderëve. Mendoj se këto tani për tani janë më pak të rëndësishme.

**"Epoka e re":** *As subjektet opozitare nuk e kanë mirëpritur që presidenti të jetë në krye të këtij procesi. LV-ja është shprehur kundër, ndërsa LDK-ja ende nuk ka marrë një qëndrim, ani pse disa prej zyrtarëve të lartë të saj janë shprehur kundër?*

**Pajaziti:** Mendoj se një pjesë e debati që është zhvilluar deri më tani dhe qëndrimeve që kanë dalë prej disa eksponentëve të partive opozitare, më shumë e shprehin komunikimin e tyre me elektoratin e vet sesa një qëndrim të pjekur politik me interes nacional të vendit. Jam i sigurt se në Kuvend do të mbizotërojnë zërat që kanë në plan të parë interesin e shtetit tonë në këtë proces. Pra, do të duhej të dalin përmbi zërat partiakë. Debati për këtë çështje duhet të jetë serioz dhe t'i përvishemi bashkë punës, pozitë dhe opozitë, në këtë proces të cilin duhet ta përmbyllim.

**"Epoka e re":** *Në këtë proces po kërkohet edhe një konsensus nacional. Sa është e mundshme kjo, meqenëse në tryezat e partive politike ende nuk është arritur asgjë?*

**Pajaziti:** Mendoj se një farë konsensusi mund të arrihet për çështjen e vazhdimit të dialogut, sidomos për dimensionin që duhet të ketë ky proces, në mënyrë që ne të mos lëshojmë pe përtej asaj që është thënë në Kushtetutë. Mirëpo, nuk besoj se do të ketë gjithmonë konsensus për çështjet më të vogla të këtij procesi. Pra, konsensusi duhet të arrihet për një platformë, për disa vija, për disa pika themelore. Nuk është e thënë të ketë konsensus për gjëra teknike apo për gjëra të specifikuara gjatë procesit. Do të jetë një fitore e madhe për ne që të kemi një platformë për këtë proces dhe të pajtohemi në Kuvend për këtë dokument.

**"Epoka e re":** *A duhet opozita të marrë përgjegjësi në këtë proces, meqenëse dialogu me Serbinë është një çështje nacionale?*

**Pajaziti:** Nëse partitë në pushtet do të tentonin ta përvetësonin këtë proces, partitë opozitare nuk do të duhej ta lejonin një gjë të tillë. Nuk besoj se do të kenë farë kalkulimi të mirë politik për ata që dëshirojnë të mbeten jashtë këtij procesi, dhe nesër të thonë se ne nuk jemi pajtuar me këtë apo atë. Në çastet vendimtare, historike për vendin, të gjithë duhet të jenë aty. Interesi i vendit mendoj se është i përputhshëm edhe me interesat politike të partive, që të jenë të gjithë në proces.

# Programeve ekzistuese u vazhdohet akreditimi edhe për një vit

**Prishtinë, 3 qershor** - Agjencia e Akreditimit e Kosovës ka vendosur të zgjasë edhe për një vit të gjitha akreditimet e programeve ekzistuese, ndërsa nuk do të bëhet akreditimi i programeve të reja për këtë vit.

Ky vendim është marrë për të gjitha institucionet e arsimit të lartë publik e privat. Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" ka pasur në proces të akreditimit dhe të riakreditimit 103 programe, ku shtatë prej tyre janë programe të reja studimi.

Për shkak të rrethanave që janë krijuar, në mungesë të funksionalizimit të Bordit të Agjencisë së Akreditimit, ka qenë e pamundur që për një afat të shkurtër kohor të bëhet vlerësimi i programeve të institucioneve të arsimit të lartë, të cilat kanë qenë në proces të riakreditimit apo të akreditimit.

Kryetari i këtij bordi, Gazmend Luboteni, ka thënë për "Radio Kosovën" se numri i kërkesave për akreditim institucional, akreditim të programeve të reja dhe riakreditim të programeve ekzistuese, ka qenë shumë i madh dhe nuk ishte e mundur të shqyrtohen të gjitha. Për këtë arsye, ai ka thënë se është marrë vendimi të bëhet shtyrja e këtij procesi për një vit. "Për shkak se procesi i vlerësimit merr kohë, ndërsa ne jemi në një fazë që nuk kemi kohë t'i thërrasim ekipet e ekspertëve që vijnë nga jashtë për ta bërë vlerësimin dhe t'i vizitojnë institucionet, ne kemi marrë vendim, që parashihet me rregullore në situata të jashtëzakonshme siç ka qenë kjo e jona, që të bëhet shtyrja e akreditimit për një vit. Kështu që, për programet ekzistuese dhe për ato në riakreditim ne kemi vendosur njëjtë për të gjitha institucionet, qoftë publike apo private, që t'u shtyhet për një vit", ka thënë Luboteni.

Ndërkohë, për këtë vit akademik nuk do të bëhet akreditimi i asnjë programi të ri studimi. Institucioni i arsimit të lartë, më i madhi në vend, Universiteti i Prishtinës, ka pasur në proces të akreditimit dhe riakreditimit 103 programe, ku shtatë prej tyre janë programe të reja studimi.

Prorektori për mësimdhënie në Universitetin e Prishtinës, Hysen Bytyqi, ka thënë për "Radio Kosovën" se për këtë vit janë bërë përgatitjet edhe për akreditim institucional për të gjithë Universitetin, i cili është shtyrë për një vit. "Disa nga programet ku numri i tyre është shtatë e disa kanë qenë në proces të pritjes që të caktohen ekipet që do të duhej të vinin dhe mandej, bazuar në vlerësimin, të merret vendimi përfundimtar dhe prej disa prej tyre realisht kemi pritur të startojmë në tetor dhe kjo na pengon pak neve si Universitet. Tani programet të cilat vetëm i kemi pasur në planifikim për akreditim që t'i vendosim në pozicionin e aplikimit, ndoshta na duhet kohë për shkak se ata e kanë shtyrë këtë proces", ka thënë Bytyqi.

Bordi i Agjencisë së Akreditimit tashmë do të vazhdojë me procedura të tjera, ku do të shqyrtojë të gjitha aplikimet nga institucionet e arsimit të lartë në vend, publik e privat, dhe brenda një viti do të bëhet vlerësimi i tyre. Gjithashtu, do të ftohen edhe ekspertët ndërkombëtarë, të cilët do t'i vizitojnë këto institucione.



# Më 24 qershor mbahet Kuvendi Qendror i Nismës

Kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, ka bërë me dije se më 24 qershor partia që drejton do ta mbajë Kuvendin Qendror, në të cilin do të zgjedhën organet e reja drejtuese. Ai ka thënë se Nisma Socialdemokrate po gjen mbështetje anekënd vendit. "Subjekti ynë është shndërruar në subjekt politik, shpresë e mundësi për vendin", ka thënë Limaj



EPOKA E RE Arbisa SHEFKIU

PRISHTINË, 3 QERSHOR - Kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, në një konferencë për medie ka thënë se partia që drejton ka filluar një proces të gjerë të konsolidimit të saj. Ai ka thënë se nga sot Nisma fillon kuvendet e punës së degëve të partisë në gjithë Kosovën. Limaj ka bërë me dije se më 24 qershor Nisma Socialdemokrate do ta mbajë Kuvendin Qendror, në të cilin do të zgjedhën organet e reja drejtuese. Ai ka treguar se në mbi 700 nëndegë të Nismës është mbajtur procesi zgjedhor. Limaj ka thënë se Nismës janë duke iu bashkuar mijëra qytetarë. "Nisma ka dëshmuar se i qëndron zotimeve të saj. Nisma në nivelin qendror në qeveri dhe kuvend është duke u angazhuar për t'u implementuar programi qeverisës dhe brenda atij programi janë zotimet tona si subjekt politik. Angazhimet tona do të vazhdojnë që të kemi një qeverisje më të suksesshme në nivelin qendror dhe në atë lokal", ka thënë Limaj, i cili mban postin e zëvendëskryeministrit në Qeverinë e Kosovës.

Limaj gjatë dy ditëve të fundit ka marrë pjesë në aktivitetet e organizuara nëpër degë të Nismës. Ai ishte i pranishëm në Kuvendin e Punës së Degës së Nismës Socialdemokrate në Gjakovë. Limaj ka thënë se nga ky kuvend Dega e Nismës në Gjakovë do të dalë edhe më e fuqishme. "Falënderoj të gjithë aktivistët për punën e palodhshme që kanë bërë gjatë gjithë kësaj kohe. Nisma Socialdemokrate po gjen mbështetje anekënd vendit. Subjekti ynë është shndërruar në subjekt politik, shpresë e mundësi për vendin. Qindra intelektualë të Kosovës po e zgjedhin Nismën për ta dhënë kontributin e vet dhe ne ndihemi të nderuar. Qëndrimet tona të matura kanë gjetur simpati dhe janë përshëndetur edhe nga ata që nuk janë votues të Nismës dhe qëllimi ynë është ta bëjmë më të mirën për vendin", ka thënë Limaj.

Në takimin me strukturat e Nismës në Shtime, Limaj ka thënë ky subjekt politik tani ka kaluar në një fazë tjetër. Sipas tij, partia të cilën ai e drejton ka kaluar nëpër shumë vështirësi që nga fillimi, por të gjitha këto janë kaluar me një qëndrim të qartë në tema të rëndësishme për vendin. "I kemi zhgënjyer shumë skeptikë për pritjet që kanë pasur për këtë parti. Rezultati dhe sukseset e Nismës janë për disa arsye, por e para është puna ekipore. Është vizioni ynë i qartë ku duam të shkojmë dhe përcaktimi ynë që të punojmë fort në temat që i shërbejnë vendit", ka thënë Limaj.

# Haradinaj: Pajtimi me Serbinë, vetëm në këmbim të njohjes

PRISHTINË, 3 QERSHOR - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka thënë se Kosova do të pranojë pajtimin me Serbinë në këmbim të njohjes. Sipas tij, kjo nuk do të thotë se do të harrohen krimet e bëra. Haradinaj ka thënë për "RTK 2" se pajtimi nënkupton të kalohet mbi të zhdukurit, të dhunuarit e të vrarët, por ka shpjeguar si duhet bërë kjo. "Njohja... çka mund të jep Kosova që të arrihet kjo marrëveshje, një pajtim, se tjetër nuk kemi çfarë japim. Pajtimi nuk është pak, do të thotë të kalohet mbi dhimbjen tonë, mbi të zhdukurit, mbi të vrarët, mbi dëmet, mbi dhunimet seksuale, me ekonomi të shkatërruar e të plaçkitur, e kur ne të pajtohemi, po japim shumë më shumë sesa që dikush do të kishte për të dhënë. Nuk po themi për ta harruar, se nuk e bëjmë kurrë, por mund të pajtohemi ndonjëherë, për njohje. A është ky vit për këtë? Nuk mund të ngutem të them për këtë, por ne kemi kërkuar ndihmën e miqve tanë dhe po ju tregoj se Kosova kur qëndron pas Amerikës, e bën për interesin e vet", ka thënë Haradinaj.




Kryeministri mendon se Kosova këtë vit duhet të anëtarësohet në organizata ndërkombëtare, sidomos në atë të INTERPOL-it. Haradinaj u shpreh i bindur se do të ketë vende që do ta kërkojnë anëtarësimin e Kosovës në këtë organizatë. "Çdo vend që e pengon Kosovën të anëtarësohet në INTERPOL është duke e ndihmuar luftimin e krimit transnacional. Është gabim. Kush do ta luftojë krimin transnacional e ndihmon Kosovën të anëtarësohet në INTERPOL. Këtë vit është koha kur duhet të vendoset kjo punë. Jam thellë i bindur që plot vende do ta kërkojnë anëtarësimin e Kosovës në INTERPOL, se ashtu luftohet krimi transnacional që është i rrezikshëm, është kërcënim", ka thënë Haradinaj. Ai ka kërkuar nga shtetet mike ta ndihmojnë Kosovën të anëtarësohet në Interpol. Haradinaj ka folur edhe për anëtarësimin e Kosovës në OKB. Sipas tij, shpejt duhet të mbyllet kjo çështje.

# Lugina e Preshevës, e pakënaqur me përkrahjen e Kosovës dhe Shqipërisë

Lidershipi në Luginë të Preshevës është shprehur i pakënaqur me përkrahjen e Kosovës dhe të Shqipërisë. Sipas tyre, këto dy shtete duhet ta ngrehin zërin në institucionet ndërkombëtare për shkeljen e të drejtave të shqiptarëve të Luginës së Preshevës



EPOKA E RE Qendresa RAMA

Prishtinë, 3 qershor - Kryetari i Partisë Demokratike Shqiptare (PDSh), Ragmi Mustafa, ka thënë se gjendja në Luginën e Preshevës nuk ka ndryshuar meqë nuk ka ndonjë përparim për realizimin e të drejtave të shqiptarëve. Mustafa ka theksuar për "Epokën e re" se shqiptarët janë në pritje për realizimin e të drejtave të tyre në të gjitha fushat, sidomos në përdorimin e lirë të gjuhës shqipe, flamurit kombëtar, teksteve mësimore, si dhe lëvizjes së lirë. "Gjendja nuk ka ndryshuar sepse nuk ka ndonjë përparim për realizimin e të drejtave të shqiptarëve në Luginën e Preshevës. Pavarësisht prej miratimit të një shtatëpikëshi që kishte dhënë Qeveria në vitin 2013, për të cilin Vuçiqi e Daçiqi premtuan se do të jetë lehtë i realizueshëm, nuk ka asnjë lëvizje. Shqiptarët janë ende në pritje për realizimin e të drejtave të tyre në të gjitha fushat, sidomos në përdorimin e lirë të gjuhës shqipe, flamurit kombëtar, teksteve mësimore, si dhe lëvizjes së lirë. Një problem tjetër është shkalla e zhvillimit ekonomik e cila është mbase më e ulëta në Ballkanin Perëndimor. Për këtë një numër i madh i të rinjve po migrojnë drejt Kosovës, Shqipërisë si dhe vendeve të Evropës. Ky është projekt i Serbisë që po zbatohet për të krijuar pasiguri te shqiptarët dhe për t'i përndjekur ata me metodat më të moderuara drejt vendeve të treta në mënyrë që ky vend t'u mbetet serbëve pa ushtrimin e një lufte të armatosur. Fatkeqësisht, Lugina ka një kujdes minimal të Qeverisë së Shqipërisë dhe më minimal një kujdes të Qeverisë së Kosovës", ka thënë Ragmi Mustafa. Ai ka shtuar se Kosova dhe Shqipëria është dashur të interesohen për shqiptarët në Luginë të Preshevës sikurse që kujdeset Serbia për serbët në Kosovë. "Shqiptarët në Serbi duhet ta kenë tretmanin e njëjtë sikur serbët në Kosovë. Kosova dhe Shqipëria kanë mundur ta ndihmojnë Luginën e Preshevës në fushën e arsimit, të papunësisë dhe zhvillimit ekonomik. Megjithatë, përveç nga 50 mijë euro që i patën dhënë për ngritjen e maternitetit, nuk ka pasur ndihmë tjetër. Ne jemi shumë falënderues edhe për këtë ndihmë, por kemi nevojë që ndihma dhe kujdesi të vazhdojnë. Lugina ka nevojë për projekte që mundësojnë hapjen e vendeve të punës, sidomos për zhvillimin e bujqësisë dhe tregtisë. Këto janë të domosdoshme për t'i mbajtur gjallë shqiptarët në Luginë. Po ashtu, Kosova e Shqipëria duhet ta ngrehin zërin në institucionet ndërkombëtare për shkeljen e të drejtave të shqiptarëve të Luginës së Preshevës", ka deklaruar kryetari i Partisë Demokratike Shqiptare (PDSh), Ragmi Mustafa.

# Hasani: Serbët duan të dalin nga dialogu me autonomi territorial



Prishtinë, 3 qershor - Ridefinimi i raporteve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, që pritet të dalë si rezultat i përfundimit të dialogut në Bruksel, nuk do të kalojë pa kompromise nga të dyja palët, thotë Enver Hasani, profesor i së Drejtës Ndërkombëtare. Ai në një intervistë për "Radion Evropa e Lirë" ka thënë se pret përplasje të palëve gjatë fazës së fundit të dialogut në Bruksel, ndërkohë që, sipas tij, pala serbe është treguar deri më tash më kohezive sesa pala e Kosovës, tek e cila vazhdojnë polemikat se kush duhet ta drejtojë ekipin në bisedime. "Ajo çka kërkojnë serbët me Asociacion është, si të thuash, t'i krijosh një shtrat politiko-territorial planit të Ahtisarit sa iu përket të drejtave të komuniteteve. Do të thotë, Plani i Ahtisarit i ka pasur të gjitha, vetëm jo këtë që e thotë se Asociacioni është shtrati territorial. Të drejtat që janë sot në kapitullin e tretë të Kushtetutës, për ato të drejta po përpiqen që t'u krijojnë në shtrat territorial, brenda të cilit ai Asociacioni, ato ingerenca nga e drejta publike do t'i realizonte", ka thënë Hasani.

I pyetur nëse Kosova mund ta sigurojë ulësen e saj në Kombet e Bashkuara dhe perspektivën e qartë integruese për në BE përmes marrëveshjes finale me Serbinë, Hasani ka thënë se tani çështja është që, nëse do të arrihet një marrëveshje dhe çfarë natyre do të ketë ajo? "Ajo marrëveshje mund të parashikojë një dinamikë që në këtë rast, unë besoj se do të jetë një proces çështja e integrimit në Evropë, në OKB dhe kështu me radhë, i Kosovës dhe i Serbisë. Do të jetë një proces ku parashihen afatet dhe lëvrimet politike që duhet t'i bëjë palët kundrejt njëra-tjetrës dhe një garantues. Do të thotë, duhet patjetër të ekzistojë një këshill zbatues, në mënyrë që ta vërtetojë nëse palët po i përmbahen marrëveshjes. Përndryshe, do të ndodhë sikurse me këto marrëveshjet e Brukselit, që nuk kanë pasur ndonjë efekt substancial në përafrimin e qëndrimeve të palëve", ka thënë Hasani.




# Kurti: Gjendja në Telekom si pasojë e krimit të organizuar

Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, në një konferencë për medie mbajtur të dielën, në të cilën ka folur për zgjidhjen në Telekomin e Kosovës pas gjendjes së rënduar, ka thënë se gjendja në këtë ndërmarrje është si pasojë e krimit që është bërë në të. Ndërkaq Ismet Hamiti, njohës i telekomunikacionit, ka thënë se Prokuroria e Shtetit mund ta shpëtojë Telekomin e Kosovës

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

**Prishtinë, 3 qershor** - Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, dhe eksperti për telekomunikacion në këtë lëvizje, Ismet Hamiti, në një konferencë për medie mbajtur të dielën kanë ka folur për zgjidhjen në Telekomin e Kosovës pas gjendjes së rënduar. Lideri i Vetëvendosjes, Albin Kurti, ka thënë se gjendja e sotme në Telekomin e Kosovës është pasojë e krimit të organizuar dhe korrupsionit të nivelit të lartë. Ai ka theksuar se në Telekomin e Kosovës janë bërë krime dhe nuk janë bërë hetime. "Kanë përfituar biznesmenë privatë e zyrtarë shtetërorë, por është dëmtuar qytetari dhe shteti. Në Telekomin e Kosovës nuk janë lejuar investimet dhe vazhdimisht Telekomi është kërcënuar me privatizim. Njeriu i cili e ka paralajmëruar qysh më 30 mars 2007 krimin e organizuar në Telekomin e Kosovës është këtu me ne sot, profesor Ismet Hamiti, profesionist i telekomunikacionit me përvojë gjysmëshekullore në Kosovë dhe në ITU, në letrën e tij dërguar Prokurorit të Shtetit me emër e mbiemër denoncoi përgjegjësit për katandisjen me paramendim të Telekomit të Kosovës. Ne konsiderojmë se Telekomi i Kosovës edhe mund të shpëtohet, edhe mund të zhvillohet", ka thënë Kurti.

Ndërkaq eksperti për telekomunikacion në këtë lëvizje, Ismet Hamiti, ka pohuar se Telekomi i Kosovës është në gjendje të keqe. "Aq në gjendje të keqe është sa nuk mund t'i mbulojë as shpenzimet e veta rrjedhëse, ani pse Telekomi është kompani shumë fitimprurëse. Është në këtë gjendje për arsye të vetme: sepse fitimet i janë plaçkitur dhe i plaçkiten përmes mekanizmave nga më të ndryshmit, që nga tenderë e kontrata të dëmshme e deri te humbjet e inskenuara të 'arbitrazheve'. Përgjegjëse për këtë gjendje janë të gjitha qeveritë e pasluftës, përfshirë edhe këtë të sotmen, të cilat kanë pasur dhe vazhdojnë ta kenë rolin kryesor në të gjitha zhvillimet negative në Telekomin e Kosovës", ka thënë Hamiti.

Ai ka theksuar se qeveritë fillimisht eliminuan apo mënjanuan gjithë kuadrin profesional që kishte Telekomi dhe i zëvendësuan me njerëzit e vet, të huaj e vendorë, të gjithë të padijshëm, të papërgjegjshëm dhe me prirje kriminale. "Si të kontrolluar që ishin këta individë punuan e punojnë jo për interesin e Telekomit, por për llogarinë e atyre që i kishin emëruar aty. Individë të tillë zbatuan 'idenë' e shefave të vet për krijimin edhe të skemës plaçkitëse nën maskën e 'operatorit mobil virtual'. Përmes kësaj skeme 30 % të të hyrave të Telekomit shkojnë në xhepa të një kompanie private të njohur si 'Z-Mobile'", është shprehur ai.

Hamiti ka thënë se Qeveria duhet të krijojë një ekip që Telekomi të shpëtohet. "Prokuroria duhet t'i nisë hetimet", ka deklaruar Hamiti. "Formalisht prokurorisë ia kam paraqitur para një viti e gjysmë, por para kësaj ia kam paraqitur Zyrës për Kontroll të Brendshëm të OKB-së (OIOS) dhe gjithë kryeprokurorëve të EULEX-it më pas. Por, vetëm në dhjetor të vitit të kaluar prokuroria e gjeti të udhës të më ftojë të them diçka për këtë krim, por jo për krimin si tërësi, por vetëm për një hallkë të vogël të tij", ka thënë ai.

Në këtë drejtim Hamiti ka theksuar se prokuroria e këtij vendi nuk është e interesuar ta hetojë plaçkitjen e Telekomit të Kosovës duke u bërë kështu pjesë e krimit të organizuar që krijoi skemën plaçkitëse. "Prokuroria dëshiron ta amnistojë, edhe pse ky rast është shkollor, i një krimi që është lehtësisht i provueshëm. Përkundër kësaj, prokuroria nuk vepron dhe ky është shkaku që më shtynë ta përsëris edhe një herë se prokuroria e ka në dorë ta shpëtoj Telekomin. Vetëm duhet ta kryejë punën e vet", ka thënë Hamiti.

# Sektori bankar për tre muaj me fitim prej 17.9 milionë eurosh

Në raportin e Bankës Qendrore të Kosovës (BQK) bëhet me dije se norma e interesit në kredi në tremujorin e parë (TM1) 2018 ka qëndruar në nivel prej 6.9 përqindësh, kurse në depozita në 1.1 për qind. "Sektori bankar u karakterizua me performancë të kënaqshme financiare gjatë TM1 2018, duke realizuar fitim neto prej 17.9 milionë eurosh, që është më i ulët krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit paraprak", është thënë në raportin "Vlerësimi Tremujor i Sistemit Financiar Nr. 22"

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

**Prishtinë, 3 qershor** - Sipas raportit të fundit të Banës Qendrore të Kosovës (BQK) "Vlerësimi Tremujor i Sistemit Financiar Nr. 22", për vlerësimin e tremujorit të parë (TM1) të vitit 2018, sistemi financiar në vend ka shënuar rritje edhe gjatë tremujorit të parë të vitit 2018. Megjithëse, sipas BQK-së, analiza krahasimtare tremujore sugjeron një zvogëlim të aseteve të sistemit financiar në TM1 2018, kryesisht si pasojë e zvogëlimit të aseteve të sektorit bankar dhe atij pensional. "Sektori bankar në TM1 2018 është karakterizuar me rritje të aktivitetit kreditues, performancë të mirë financiare si dhe nivel të kënaqshëm të indikatorëve që matin shëndetin e sektorit. Në TM1 2018 asetet e sektorit bankar u zvogëluan për 4.6 milionë euro, kryesisht rezultat i tkurrjes së kategorisë së parasë së gatshme dhe bilancit të mbajtur në BQK, si dhe kategorisë së investimeve të mbajtura në bankat e tjera. Rritja e gjithsej stokut të kredive, ndër të tjera, erdhi si rezultat i rritjes së kredive të reja gjatë kësaj periudhe, veçanërisht kredive me karakter investues (ndërmarrje) dhe atyre për konsum (ekonomi familjare)", është thënë në këtë raport. Sipas këtij raporti të BQK-së, sektorët ekonomikë që u kredituan më shumë në këtë periudhë ishin tregtia, bujqësia dhe prodhimtaria. "Rritja e kreditimit vazhdon të financohet kryesisht nga depozitat e mbledhura brenda ekonomisë së vendit, të cilat në fund të TM1 2018 përfaqësuan 79.4 për qind të gjithsej detyrimeve të sektorit. Në TM1 2018 depozitat u zvogëluan për 18.3 milionë euro si pasojë e tkurrjes së depozitave të ndërmarrjeve të mbajtura në sektorin bankar gjatë kësaj periudhe", thuhet në raportin e BQK-së.

Në tremujorin e parë të këtij viti normat e interesit në kredi kanë vazhduar trendin rënës, kurse ato në depozita kanë shënuar një rritje të lehtë vjetore. "Norma e interesit në kredi në TM1 2018 qëndroi në nivel prej 6.9 përqindësh, kurse në depozita në 1.1 për qind. Sektori bankar u karakterizua me performancë të kënaqshme financiare gjatë TM1 2018, duke realizuar fitim neto prej 17.9 milionë eurosh, por që është më i ulët krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit paraprak. Rënia e lehtë e profitit të realizuar ishte kryesisht pasojë e rritjes së shpenzimeve, përderisa të hyrat mbetën në nivel të ngjashëm me periudhën e kaluar. Sektori bankar shënoi përmirësim të indikatorëve kyçë të shëndetit financiar. Në TM1 2018 niveli i kredive joperformuese qëndroi në nivel prej 2.9 përqindësh, kurse mbulueshmëria e tyre me provizione në nivel prej 155.1 përqindësh. Në të njëjtën periudhë treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit qëndroi në nivel prej 18.3 përqindësh, përderisa sektori gëzoi edhe nivel të kënaqshëm të likuiditetit prej 35.9 përqindësh", thuhet më tej në raportin e BQK-së.

Më tej, theksohet se sektori pensional në tremujorin e parë (TM1) 2018 ka shënuar rënie të aseteve, megjithëse stoku i gjithsej aseteve të sektorit ka shënuar rritje që u reflektua edhe në rritjen e peshës së sektorit në asetet e sistemit financiar krahas periudhës së njëjtë të vitit paraprak. "Në tremujorin e parë ky sektor u karakterizua me ecuri pozitive të kontributeve të reja, ndërsa performancë negative pati sa i përket kthimit bruto nga investimet. Sektori i sigurimeve mbylli këtë tremujor me rezultat pozitiv financiar, megjithëse në vlerë më të ulët krahas tremujorit të njëjtë në vitin paraprak. Më saktësisht, faktorët që ndikuan në dinamikat e sektorit të sigurimeve ishin rritja në të hyrat neto nga primet dhe menaxhimi efikas i shpenzimeve të sektorit, ndërsa faktorët të cilët kontribuan negativisht ishin zvogëlimi i aseteve dhe rritja e theksuar e dëmeve të ndodhura gjatë TM1 2018", thuhet në raport, duke shtuar se sektori mikrofinanciar ka vazhduar ta rrisë aktivitetin, ku edhe tremujori i parë u karakterizua me rritje të theksuar të aseteve si rezultat i rritjes së stokut të kredive të këtij sektori. "Njëkohësisht, dinamikat në këtë sektor dhe rritja e konsiderueshme e të hyrave rezultuan në rritje të profitit gjatë tremujorit të parë të vitit 2018. Tregu i letrave me vlerë të Qeverisë së Kosovës gjatë këtij tremujori u karakterizua me rritje të vlerës së emetuar dhe rritje të afatit të maturimit, por kërkesë më të ulët për të investuar në letrat me vlerë, gjë që mund të ketë ndikuar në rritjen e normës së përgjithshme të interesit në TM1 2018", thënë në raportin e BQK-së.



## Nesër të rinjtë mund t'i shpalosin idetë e tyre inovative




**Prishtinë, 3 qershor (ER)** - Nën përkujdesjen e Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, nesër (e martë) do të mbahet aktiviteti "Think Future - Prizren" në Kinemanë "Lumbardhi" në qytetin e Prizrenit. Ministri i Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, Besim Beqaj, ka bërë me dije se ky aktivitet ka për qëllim promovimin e "Programit për financimin e organizatave joqeveritare" dhe "Parkut të Inovacionit dhe Trajnimit në Prizren". "Do të shpalosen mundësitë e të rinjve për financimin e ideve inovative që kanë për synim mbështetjen e inovacionit dhe ndërmarrësisë në Republikën e Kosovës. Gjithashtu, do të prezantohen mundësi tjera për fuqizimin ekonomik të të rinjve", ka thënë ministri Beqaj.

## Përkujtohet dëshmori Zejnulla Zejna

**Ferizaj, 3 qershor (ER)** - Kryetari i Komunës së Ferizajt, Agim Aliu, i shoqëruar edhe nga përfaqësues të Shoqatës së Familjeve të Dëshmorëve, Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së në Ferizaj, familjarë dhe bashkëluftëtarë, kanë përkujtuar të dielën dëshmorin e kombit Zejnulla Zejna, në ditën e rënies së tij për lirinë e Kosovës.
Me këtë rast, Aliu ka thënë se amaneti i dëshmorëve është duke u jetësuar. "Sot përkujtuam dëshmorin e kombit Zejnulla Zejna. Amaneti i tyre fisnik për lirinë dhe zhvillimin e vendit po jetësohet çdo ditë nga burrat e gratë e këtij vendi, që gjeneratat e reja të kenë një të ardhme më të mirë", ka thënë Aliu. Ndërsa Gafurr Bytyçi, kryetar i Shoqatës së Familjeve të Dëshmorëve, ka thënë se këto ditë përkujtimi janë ditë dhembje dhe krenarie si për familjarët, shokët, miqtë dhe për shoqërinë.



# Promovohet libri me poezi i Erjon Hadergjonajt 'Në ishullin e ëndrrave'

"Në librin tim nuk munda t'u ik emocioneve kur humba gjyshërit e mi. Ata ishin motivi im për të hapëruar me kohën. Mallin, dhimbjen, dashurinë e gjeni aty, në poezitë e mia", ka thënë Erjon Hadergjonaj, autor i librit me poezi "Në ishullin e ëndrrave"



**Deçan, 3 qershor (ER)** - Në Deçan është promovuar libri i dytë me poezi, me titull "Në ishullin e ëndrrave", i autorit Erjon Hadergjonaj. Në promovimin e këtij libri morën pjesë deputetë të Kuvendit të Kosovës, përfaqësues të qeverisjes lokale në Deçan, kryetari i komunës Bashkim Ramosaj, dashamirës të letërsisë, familjarë dhe qytetarë të shumtë. Ky libër me poezi nga të pranishmit u vlerësua shumë, duke e uruar Erjonin të vazhdojë edhe më tutje të shkruajë.
Erjon Hadergjonaj në fjalën e tij ka falënderuar të gjithë ata që deri më sot e kanë mbështetur në krijimtarinë e tij letrare, sidomos familjen e cila, sipas tij, ishte çdo herë pranë tij. "Libri titullohet 'Në ishullin e ëndrrave' sepse ne jetojmë në një vend të ëndrrave që presim të bëhen realitet. Pikërisht në këtë ishull të ëndrrave bëhet një punë e madhe që shtigjet e së ardhmes të jenë sa më të shndritshme. Motivi im kryesor për




të shkruar është frymëzimi që marr nga e kaluara jonë e lavdishme", ka thënë Hadergjonaj, duke shtuar se përmes rreshtave poetikë është përpjekur ta shprehë admirimin për historinë tonë, me mesazhin që të kemi gjithmonë si objektiv madhor, dinjitetin dhe figurën e heronjve tanë. "Realiteti sfidues i të rinjve për vite të tëra është një mesazh i fortë për të gjithë ne. Ajo rinia heroike na jep shembullin më të mirë se si rinia e një vendi është vetë ajo që udhëheq një shtet, që lufton për të, që punon për të", ka thënë autori i librit Erjon Hadergjonaj.
Ai ka shtuar se trashëgimia jonë e pasur, kullat e gurit, kalldrëmet e lara me gjak lirie, vlerat kulturore e etnografike e kanë motivuar për paraqitje artistike përmes vargjeve. "Në librin tim nuk munda dot t'u ik emocioneve kur humba gjyshërit e mi. Ata ishin motivi im për të hapëruar me kohën. Mallin, dhimbjen, dashurinë i gjeni aty, në poezitë e mia", ka thënë autori i ri, Hadergjonaj. Ai ka theksuar se do të vazhdojë me aktivitete të tilla. "Unë dhe të gjithë bashkëmoshatarët e mi do të vazhdojmë të kemi aktivitete të tilla, që t'i ngrehim sa me lart vlerat e shoqërisë sonë. E ardhmja na takon neve sepse besojmë në bukurinë e ëndrrave tona", ka thënë Hadergjonaj.






# Drenasi, përfitues i projektit 'Gara për mjedis të pastër'

**Drenas, 3 qershor (ER)** - Komuna e Drenasit ka përfituar një projekt në vlerë mbi 180 mijë euro, në kuadër të garës për mjedis të pastër nga Qeveria Gjermane, përmes Agjencisë Gjermane për Zhvillim (GIZ), ku ishin të përfshira 17 komuna të Kosovës. Ky grant i është ndarë Komunës së Drenasit gjatë konferencës për ambientin që është organizuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe GIZ-i gjerman, që ka për vlerësim progresin e arritur në pastrimin e ambientit dhe eliminimin e mbeturinave. Në këtë ngjarje kanë marrë pjesë nënkryetari i Komunës së Drenasit, Gani Sylaj dhe drejtoresha e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë, Lumnije Krapi.

## Edhe këtë javë mot i nxehtë

**Prishtinë, 3 qershor (ER)** - Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës (IHMK) ka njoftuar se gjatë pesë ditëve të ardhshme moti në vendin tonë do të jetë me diell dhe me reshje lokale të shiut. "Do të mbajë mot me diell dhe vranësira të cilat vende-vende do të shoqërohen me reshje lokale shiu. Kjo situatë e paqëndrueshme sinoptike do të vazhdojë deri të mërkurën, pastaj priten alternime kthjellime dhe intervale të gjata me diell. Temperaturat minimale parashihen të lëvizin ndërmjet 12-14 gradë celsius, ndërsa maksimalet e ditës parashihet të lëvizin ndërmjet 26-30 gradë celsius. Do të fryjë erë kryesisht nga jugperëndimi me shpejtësi deri 8m/s", është thënë në njoftimin e IHMK-së.



# LDK-ja, kjo parti oportuniste, klienteliste dhe pa kurriz të qëndrueshëm politik



Behxhet Sh.
SHALA - BAJGORA

Lartmadhëria dhe Shkëlqesia e Tij, presidenti i Republikës së Kosovës, zotëri Hashim Thaçi, dëshiron të jetë udhëheqësi i vetëm në bisedime me Beogradin, përkatësisht me "ortakun" Aleksandar Vuçiq, i cili, për dallim nga z. Thaçi, paraqet fuqi të pakundërshtueshme në Serbi sikur që është lojtar i madh në skenën ndërkombëtare që i solli shumë përfitime politike, sidomos ekonomike Serbisë. Vuçiqi u bë tërheqës për të gjithë: arabët në Kosovë investonin për t'i bërë falas synet fëmijët e shqiptarëve, kurse në Serbi investuan dhe po investojnë miliarda euro dhe dollarë. Turqit, me arkadashin e Thaçit dhe të Ramës, Erdoganin, në Serbi po investojnë miliarda euro, kurse në Shqipëri po investojnë për mbylljen e shkollave të Gylenit dhe hapjes së shkollave të Erdoganit, si kontribut për ngritje të vetëdijes kombëtare të shqiptarëve kurse, në Kosovë, përveç investimeve të ngjashme sikur në Shqipëri, si bonus investime janë mjetet për financimin e aksioneve terroriste sikur që ishte kidnapimi i gjashtë gylenistëve dhe dorëzimi në duar të Kadiut Suprem të Turqisë, Rexhep Taip Erdogan. Fillimisht Thaçi kundërshtohej nga shumë subjekte politike për t'u legjitimuar se kryenegociatori i vetëm i Kosovës me Serbinë me shpresë se, me arritjen e marrëveshjes përfundimtare "detyruese" me Serbinë, së bashku me, më parë Ivica Daçiqin e tash me Aleksandar Vuçiqin, do ta fitojnë Çmimi Nobel për Letërsi (këtë çmim edhe mund ta fitojnë këtë vit sepse nuk ndahet fare), Çmimin Nobel për Paqe, sikur dikur Sharoni, çifut i Ruzhdi Shkodrës dhe Jaser Arafa, palestinez i nuk e di kujt. Të gjithë jemi dëshmitarë për zhvillimet pasi Sharoni dhe Arafati e fituan Çmimin Nobel për Paqe, krimet ndaj palestinezëve nuk kanë të ndalur nga shteti i Izraelit. Deri më tani, nëse e kam gabim, më përmirësoni, detyrimi ka vlejtur vetëm për palën e Kosovës, kurse pala serbe çdo marrëveshje, përkatësisht zbatimin e saj, e ka konsideruar si diçka fakultative, jodetyruese. Skena politike u mbulua me një pluhur të madh, edhe ashtu në një mjedis të kontaminuar apo thënë shqip, të ndyrë duke e kundërshtuar Thaçin si kryenegociator e në këtë kakofoni të kundërshtimeve, zëri i LDK-së dukej si më i fuqishmi dhe më përcaktuesi shkaku se aktualisht kjo parti ka më së shumti deputetë në Kuvendin e Hajkobillës apo Kuvendin e më të Urtëve dhe më të Mençurve të Kosovës. Shumica kërkonte që Kuvendi ta mandatojë apo ta pamundësojë me 2/3 e votave legjitimimin e Hashim Thaçit si kryenegociator. Dhe të gjithë deklaronin se votat nuk mund të sigurohen aq më parë që partia përcaktuese, LDK-ja, e kundërshtonte riciklimin e Thaçit si kryenegociator. Që në fillim Thaçi e siguroi përkrahjen e bashibozukëve të noterizuar sikur janë Bekimi, Enveri dhe Zezdita e më pastaj filloi të funksionojë formula e klientelizmit dhe injorancës politike. Se PDK-ja e përkrah këtë rol të privatizuar nga Hashim Thaçi, nuk paraqet befasi ngaqë kjo parti ende është në servis të Hashimit, në mos për asgjë tjetër atëherë, së paku, aty mund të pshurrë papengueshëm çdoherë kur ngacmohet për nevoja fiziologjike, sidomos për nevoja politike. Të përmendurit më lart i konsideroj si personazhe kyçe të Dekameronit moral, politik, njerëzor dhe kombëtar e që janë të barasvlershëm me personazhet e Dekameronit të Bokaços. Nisma Socialdemokrate e Kosovës, si vëlla i motrës politike të Kaçusha Shpend Jasharit, po e kundërshton Thaçin si kryenegociator jo për shkak të parimeve, po për shkak të mosdurimeve personale dhe hakmarrjes. Nuk ka logjikë ta kundërshtoni Thaçin si kryenegociator e në anën tjetër t'i pranoni të gjitha marrëveshjet dhe përqafimet plot epsh, pasion dhe tundim midis Thaçit, Viçiqit dhe Daçiqit sikur edhe platformën për bisedime. Hajt se Nisma është e vogël, po pse LDK-ja po bëhet si PDK-ja, Bekimi, Enveri dhe Zezdita?!

Nëse i dëgjoni diskutimet e deputetëve të Kuvendit nga radhët e LDK-së për Thaçin dhe rolin e tij në bisedime, atëherë fitoni përshtypjen se mëngjesi i ardhshëm nuk do ta zë gjallë presidentin post-historik! Unë habitem si kanë shpëtuar deri më tani Kadria, Hashimi dhe Ramushi pa u ekzekutuar edhe faktikisht, pas ekzekutimit oral që në vazhdimësi ua bëjnë Dritoni, Lumiri, Vjosa, Besa, Albini, sidomos për rolin e tij, e vlerësoj si shumë të dëmshëm edhe unë, në procesin e bisedimeve me Serbinë. Ç'është e vërteta, edhe Milaimi gjuan shumë, por plumbat i ka shkollorë, që nuk ta rrezikojnë jetën, kurse Zafirit duket se i është lagur baruti krejt, nga djersa apo përmjerrja, nuk e di. Hashim Thaçi është i sinqertë sepse nuk po luan lojëra prapa skene dhe në çdo përballje morale, njerëzore dhe ligjore nuk do të ndëshkohet për faktin se botërisht po e pranon se do të bëjë kompromis edhe në të ardhmen me Serbinë, por se këtë nuk e bën për shkaqe personale, po për të mirën e qytetarëve të Kosovës që aq shumë i do dhe të cilët edhe më shumë e duan atë. T'jua them të drejtën, kur e dëgjova këtë deklaratë aq të sinqertë të Hashimit, për 30 minuta nuk kam mundur t'i ndal lotët, kurse për një rast vdekjeje nuk e derdha as një lot të vetëm e që nënkupton se në këtë rrafsh jam i ngjashëm me Hashimin; që të dy i sakrifikojmë interesat personale për ato të përgjithshme! Rrej Behxhet, rrej! Hashimi, në librin që ka bërë bujë dhe rrëmujë ndërkombëtare ku përshkruhet biografia e tij, saktësisht e përshkruan Ibrahim Rugovën ashtu siç mendon për të; në një intervistë thotë se ajo nuk është deklarata e tij, por e autorëve të kësaj biografie brilante, të shkëlqyer dhe madhështore të udhëheqësit, vizionarit dhe Xhorxh Uashingtonit të Muçibabës. Pastaj, flet fjalët më të zgjedhura për Rugovën e që jam i sigurt se e mendon pikërisht të kundërtën e asaj që e thotë. Familjes Rugova ia ndanë znaçkën e dekorimit, në praninë e tërë familjes Rugova të cilët buzëqeshnin sikur të kishin shkuar në audiencë te Rasim Thaçi - Cima. Pas një jave, Mendimi i Rugovës u bë koordinator për ruajtje të mjedisit. Dhe kështu me radhë... Për të gjitha këto Hashimi u sulmua ashpër nga "skifterët" e LDK-së që nuk kanë kthetra as me u kap për m.ti e lëre për lëkurën e Hashimit që është regjur sikur të ishte e elefantit. Hashimi në të gjitha këto zhvillime po del të jetë i pafajshëm sepse po e shtynë para agjendën e tij dhe faji është vetëm i yni sepse po bëjmë zhurmë për asgjë! Po e sulmojmë Hashimin, po e shajmë Hashimin, po e quajmë tradhtar kurse, kur po na fut në grazhd, po e quajmë liberator! Me shumë fytyra jemi ne, pa asnjë dyshim! Ne e kemi ndalur Jugosllavinë dhe Serbinë, me shumë sakrifica, vuajtje, burgje, vrasje dhe luftë, kurse nuk po e ndalim Hashimin! LDK-ja po tregohet si parti oportuniste, klienteliste dhe pa kurriz të qëndrueshëm politik e për shumëfytyrësi të mos flasim sepse, në njërën anë e shanë Hashimin me fjalët më të zgjedhura, në anën tjetër, çdoherë kur Hashimi ka nevojë për ta, sipas një automatizmi të refleksit të Pavlovit, ia luajnë "bishtin" duke ia siguruar votat. Gjithmonë e kanë atë arsyetimin se, duke qenë parti institucionaliste dhe shtetformuese, nuk mund të veprojnë ndryshe! Kjo faturë e gjerë ua mbulon të gjithë klientelizmin politik dhe boshtin e deformuar kurrizor politik andaj, për t'u treguar edhe më koqemëdhenj, bëjnë përpjekjen ta marrin autorësinë dhe pronësinë mbi luftën e UÇK-së të cilën e kanë sulmuar jo të gjithë sepse një pjesë e saj u bë pjesë domethënëse dhe aktive e luftës edhe në planin verbal, duke e denoncuar në të gjitha adresat si ushtri e Serbisë dhe terroriste. A ka më e ulët se kur denoncuesit dhe penguesit e djeshëm të luftës, sot edhe komandantin legjendar, të pavdekshmin Adem Jashari bëjnë përpjekje ta përvetësojnë?! Jam i sigurt se po të ishin gjallë sot Adem Jashari, Zahir Pajaziti, Ilir Konushevci, Fehmi dhe Xhevë Lladrovci, Rexhep Mala dhe heronj të tjerë, gjërat do të zhvilloheshin ndryshe. LDK-ja duhet të përcaktohet qartë, o është sinqerisht me Hashim Thaçin, si kryenegociator, o është kundër tij?! Ndryshe, me të drejtë do të llogaritet si parti e kurtizaneve politike, morale dhe njerëzore! Nuk shkon, edhe ta shash, edhe ta duash! Në LDK ka probleme rreth pronësisë së postit të liderit, përkatësisht rreth trashëgimisë se kush do të bëhet lider. Isa në një mënyrë e ka rezervuar postin e liderit të LDK-së për Dullën e Hotëve i cili e ka një natyrë të butë, është shumë sensitiv sikur të ishte artist indian i Bollivudit dhe i cili nuk ka gjasa kundër gladiatorëve të plakur, por që ende e përdorin mirë llosin, si mjet për t'u bindur kundërshtarët, siç janë Agimi, Perëndimi, Hakia, Lutfia etj., të cilët për një post ta shkokërdhojnë Dullën stupc dhe, në fund të fundit, as Isën më nuk e pranojnë si pejgamer të LDK-së. LDK-ja, duke i siguruar votat për Hashimin, si kryenegociator, nëse ia sigurojnë, nuk ka të drejtë kurrë më ta kritikojnë Hashimin, por duhet t'ia kompensojnë të gjitha fyerjet duke ia kryer disa shërbime jashtëzakonisht të rëndësishme dhe specifike për shtetin e sidomos për Hashimin, me rritjen e temperaturave duhet të sigurojnë flladitëse funksionale për t'ia flladitur koqet Hashimit, presidentit post-historik. Tradicionalisht, në radhët e LDK-së ka pasur dhe ka edhe sot të tillë që çdokujt që ka qenë në pushtet, i kanë flladitur koqe... për fillim! Hashimi e ndien veten si superfuqi karshi bashibozukve dhe lakenjve, plus e ka përkrahjen e Mogerinit dhe duket edhe të amerikanëve për t'i përfunduar bisedimet ashtu siç i konvenon... Serbisë. Mos të flasim për këta ish-politikanë me mandat të skaduar të cilët gjatë promovimit të librit të jashtëzakonshëm dhe të mahnitshëm siç është biografia e Xhorxh Uashingtonit të Muçivërcës, për një darkë, biletë aeroplani, një dhome të hotelit me mish zogu i përgatitur me recetën e Ferid Muratit - vegetën viagra e sidomos për një honorar, më mirë flasin për Hashimin se për veten e tyre apo, për të më kuptuar më mirë ata flasin të vërtetën dhe atë që mendojnë për Hashimin sikur që Hashimi flet për të vërtetën dhe atë që mendon për Rugovën. Edhe një informatë për lexuesit e nderuar, sa vendosa të aderoj në Vetëvendosje dhe mbështetur në moshën që e kam, t'u bashkohem shpresave të kësaj partie si Hydajeti, Ismajli, Shemsia dhe riosh të tjerë, më qiti nga loja Hakif Bajrami. Kishte përparësi, si për shkak të moshës, titujve akademikë, veprave të shumta e mos të flasë për përgatitjen politike dhe kontributin patriotik. Disi e kam përshtypjen që gjithmonë po vonohem në marrjen e vendimeve.

## Merkeli me qasje përafruese ndaj qeverisë së re italiane

**BERLIN, 3 QERSHOR** - Kancelarja gjermane Angela Merkel tha se do t'i afrohet qeverisë populiste të Italisë, me një mendje të hapur dhe do të tentojë të punojë me të "në vend të spekulimit ndaj qëllimit të tyre". Partneri kyç në koalicionin e ri të Italisë, Lidhjes Djathtiste, ka qenë gjithmonë kritike ndaj Bashkimit Evropian. Lideri i kësaj partie, Matteo Slavini, ministër i Brendshëm i Italisë, tha se italianët nuk janë skllavë të shteteve të fuqishme të BE-së, si Gjermania e Franca.

Merkeli, pas këtyre komenteve, deklaroi për mediet gjermane se është më mirë të fokusohemi në diskutimin e çështjeve si ekonomia. Ajo tha se Gjermania ka në interes të ruajë Evropën dhe t'i japë zë, në një kohë kur rregulli botëror po ndryshon, duke përfshirë rolin e ShBA-së.



# Sekretari Mattis bën thirrje për vigjilencë ndaj Koresë së Veriut



Sekretari amerikan i Mbrojtjes, Jim Mattis, tha se çështja e pranisë së njësive amerikane në Korenë e Jugut nuk do të jetë pjesë e diskutimeve gjatë takimit mes presidentit Trump dhe Kim Jong Unit

**UASHINGTON, 3 QERSHOR** - Sekretari amerikan i Mbrojtjes, Jim Mattis, tha të dielën se sanksionet ndërkombëtare ndaj Koresë së Veriut do të hiqen vetëm kur Pheniani të ndërmarrë hapa konkretë për ta shpërbërë programin bërthamor. Ai qartësoi se çështja e pranisë së njësive amerikane në Korenë e Jugut nuk do të jetë pjesë e diskutimeve me Phenianin. Duke folur përkrah homologëve të Koresë së Jugut dhe Japonisë, Mattis u përpoq t'i ulë pritshmëritë për bisedimet që po zhvillohen në mes të Shteteve të Bashkuara dhe Koresë së Veriut. "Si ministra të mbrojtjes ne duhet ta ruajmë qëndrimin tonë të përbashkët për mbrojtjen, në mënyrë që në këto kohë kritike t'ua japim diplomatëve tanë mundësinë të negociojnë nga një pozicion i qetë dhe i fortë. Në veçanti tani, duhet të jemi vigjilentë dhe të vazhdojmë t'i zbatojmë të gjithë rezolutat e Këshillit të Sigurimit për Korenë e Veriut. Koreja e Veriut do të lehtësohet vetëm kur të provojë se ka ndërmarrë hapa të verifikueshëm dhe të pakthyeshëm drejt çmilitarizimit bërthamor", deklaroi Sekretari Mattis.

Ministri i Mbrojtjes i Koresë së Jugut, Song Young-moo, u shpreh më parë se ishte disi optimist. "Jam sigurisht shumë i matur për shkak të sjelljeve të Koresë së Veriut në të kaluarën. Megjithatë, shikojmë një të ardhme më të ndritur për shkak të masave që ka marrë rishtazi Koreja e Veriut dhe duhet të përfitojmë nga ky shans", tha Song Yong-moo.

Sekretari Mattis tha se çështja e pranisë së njësive amerikane në Korenë e Jugut nuk do të jetë pjesë e diskutimeve gjatë takimit në mes të presidentit Trump dhe Kim Jong Unit. Ai tha se nëse palët vendosin të diskutojnë për këtë aspekt, ajo nuk do të ndodhë në kuadrin e bisedimeve me Phenianin. Presidenti Trump pati bërë thirrje fillimisht për një proces të shpejtë çmilitarizimi bërthamor, duke thënë se përqasja graduale nuk ka funksionuar në të kaluarën. Por, pasi u takua të premten me një zyrtar të lartë koreanoverior, u duk se u tërhoq nga ky qëndrim.

## LAJME SHKURT

### Shënohet njëvjetori i sulmit terrorist në Londër



**LONDËR, 3 QERSHOR** - Kryeministrja Theresa May tha se Britania do të qëndrojë fuqishëm kundër terrorizmit, në përvjetorin e sulmit me veturë dhe thikë në Urën e Londrës.

Tetë persona u vranë dhe së paku 50 janë plagosur kur tre sulmues vrapuan drejt kalimtarëve në urë dhe sulmuan njerëzit. Ky sulm ndodhi dy javë pas eksplodimit në një koncert në Manchester, që la të vrarë 22 persona.

Shumë qytetarë, politikanë dhe punonjës të emergjencave kanë marrë pjesë në një meshë të së dielës në një katedrale afër Urës së Londrës. Shteti ka mbajtur një minutë heshtje në 4:30 pasdite.

Kryeministrja May ka nderuar ata që ndërhynë në parandalim të sulmit duke përfshirë Ignacio Echeverria, spanjolli që sulmoi sulmuesit dhe vdiq në sulm.

### Mali i Zi shënon 12-vjetorin e pavarësisë



**PODGORICË, 3 QERSHOR** - Të dielën u bënë 12 vjet nga përfundimi zyrtar i funksionimit të Konfederatës Serbi dhe Mali i Zi. Në referendumin e mbajtur më 21 maj të vitit 2006 në Mal të Zi, 55.5 për qind e qytetarëve janë shprehur për pavarësinë e Malit të Zi.

Pavarësia e Malit të Zi është shpallur më 3 qershor, ndërkohë që më 28 qershor të atij viti Mali i Zi u bë anëtar i 192-të i Kombeve të Bashkuara, ndërsa më 11 maj 2007 anëtar i Këshillit të Evropës.

### Sllovenia voton për Parlamentin e ri



**LUBJANË, 3 QERSHOR** - Sllovenët filluan të dielën të votojnë në zgjedhjet legjislative ku ish-kryeministri konservator Janez Jansha shpreson të arrijë një rikthim në pushtet pasi skena politike u trondit nga një valë migrimi në këtë vend të vogël të zonës euro që ndodhet në ish-rrugën e Ballkanit. Rreth 1.7 milion banorë pritet të votojnë në zgjedhje proporcionale që zhvillohen pas katër vjetësh qeverisje të qendrës së majtë.

I mundur në vitin 2014, pasi zhvilloi fushatën që nga burgu ku po kalonte një dënim për korrupsion, Jansha këtë herë shihet me një avantazh të lehtë nëpër sondazhe, me 25.1 për qind të pëlqimeve sipas Institutit Ninamedia.

## Asadi po përgatit takim me Kimin

**DAMASK, 3 QERSHOR** - Takimi midis presidentit amerikan Donald Trump dhe liderit të Koresë së Veriut, Kim Jongut, po afron dhe mes palëve kanë mbetur për t'u diskutuar detajet e fundit, siç është edhe akomodimi në një hotel në Singapor, i shumëpërfolur nga mediet ditët e fundit.

Por, agjencia e lajmeve të Koresë së Veriut, KCNA, jep të dielën një lajm bombastik. Ajo njofton se presidenti sirian Bashar al-Asad planifikon një samit në Phenian me udhëheqësin e Koresë së Veriut, Kim Jongun. "Do ta vizitoj Korenë e Veriut dhe do të takohem me Shkëlqesinë e Tij, Kim Jongun". Janë këto fjalët e Assadit që citon KCNA dhe nëse ky takim do të realizohej, do të ishte i pari që Kimi do ta realizonte me një lider të huaj në Phenian. Sipas burimeve të inteligjencës, marrëdhëniet ndërmjet dy vendeve përfshijnë shitjen e armëve.





Recension

# NJË DORACAK CICERON PËR GJASHTË SHEKUJ SKËNDERBE

## - Jetëshkrime, fakte, dëshmi, kallëzime, mite, rrëfime, legjenda...

**(Riza Greiçevci, "600 vjet Skënderbe", botoi shtypshkronja "Lenagrafik", Prishtinë, 2018, f. 110)**

Veli VELIU

### NË VEND TË HYRJES

Dorëshkrimi më i ri, "600 VJET SKENDERBE", i poetit, publicistit, dramaturgut, krijuesit prodhimtar të 105 veprave gjinish të ndryshme letrare, Riza Greiçevci, sjell kujtime faktesh, dëshmish, legjendash, rrëfimesh, mitesh, kallëzimesh, një doracak ciceron, që hedh dritë kujtimesh të lavdishme historike e kombëtare, në periudhë gjashtë shekuj të luftërave, epopesë së Skënderbeut. Dhe, të gjitha këto ninëza historike, mite, legjenda, dëshmi, fakte, gërshetohen në pesë shtylla, që sintetizojnë qëllimin, lavdinë e namin e luftërave të gjeneralit Gjergj Gjon Kastrioti Skënderbeu.

Kjo vepër, siç shihet, vjen në jubileun gjithëkombëtar të 550-vjetorit të kalimit në amshim të Gjergj Gjon Kastriotit Skënderbeu, një nga personalitetet më të devotshëm të historisë sonë kombëtare, mbi 600-vjeçare dhe, sipas mendimit të shkrimtarit, ky libër është një njohës i denjë dhe, ndoshta, i rrallë jo vetëm i brezave shkollarë, me "Zotin e Arbërisë", me shpëtimtarin e Evropës dhe të Atdheut, Shqipërisë, nga pushtimi shekullor i Perandorisë Osmane.

Lënda e kësaj vepre letrare jubilare, si një dhuratë e çmueshme që u jep shkrimtari, siç u tha, lexuesve të të gjitha moshave, në 550-vjetorin e kalimit në amshim të gjeneralit Gjergj Gjon Kastrioti Skënderbeu, e veçmas shkollarëve gjithandej ku lindet, jetohet, punohet e vdiset shqip, ndërtohet në pesë shtylla, ku secila shtyllë për lexuesit sjell fakte e dëshmi e të bëma të heroit të kombit, Mbretit të Shtatë Evropave, Skënderbe.

### "ZOTI I ARBËRISË"

Libri "600 VJET SKËNDERBE" hapet me rrëfimin legjendë "VENDI I SHQIPONJVAE", aty ku është dheu, është Atdheu i Arbrit, por edhe i Gjergjit, në të cilin, bashkë me 300 luftëtarë, ishte kthyer i biri i Gjonit dhe i Vojsavës, nga Anadolli, në dheun Atdhe i Shqiponjave.

Përveç fakteve e dëshmive për jetën familjare dhe të shpëtimtarit të Evropës e të Arbërisë, Gjergj Gjonit Kastriotit, z. Greiçevci, librin e thur me tekste fare të shkurtra (5- 10 rreshta), e këtë e bën për dy qëllime parësore: E para, që lexuesi i moshës së re shkollore, arsimtarët, të kenë mundësi tepër shpejt, pa ngarkesë, pa humbje kohe, të lexojë (të thith) ngjarje, sa më ma shumë fakte, dëshmi, legjenda, tregime, kallëzime, mite, që, në rrjedhë të gjashtë shekujve, kurrë s'u harruan, s'u zbehën, që flasin qartë e sinqerisht për jetën, lavdinë, për Epopenë e Skënderbeut dhe, e dyta, të dritësohet e të mësohet nga shkollarët tanë nami dhe trimëria, e gjakut të Arbrit, pra djepit legjendë të Kastriotëve dhe birit të devotshëm, zotit të Pallës, bashkimtarit të të gjithë parive luftarake e burrave në zë të Shqipërisë, siç ishte Kuvendi i Lezhës, në të cilin Gjergji, në luftë kundër pushtuesit gjashtë shekujsh të Perandorisë turke.

VITI MBARËKOMBËTAR I GJERGJ KASTRIOTIT SKËNDERBEUT - 2018 -




Këtu po sjellim disa tekste të shkurtra që flasin për gjeneralin e shtatë Evropave, Skënderbeun: Gjatë gjithë jetës së tij, Gjergj Gjon Kastriot Skënderbeu zhvilloi 30 beteja, nga të cilat: 29 prej tyre i fitoi, e humbi vetëm Betejën e Beratit.

### KUVENDI I BASHKIMIT KOMBËTAR

Më tutje, lexuesi kureshtar mund të mësojë,jetëshkrime për gjeneralin Skënderbe, "Zotin e Arbërisë", pastaj dëshmi, kallëzime, legjenda, për lufta e beteja, të Skënderbeut! Është me interes të pikaset pohimi i Aleks Budes, historian, kryetar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë:
"Veprimtaria e Skënderbeut nuk është
një balon i fryrë,
siç është thënë, por një fakt historik.
Këtu s'kemi të bëjmë vetëm
me operacione banditësh nëpër male,
por me një luftë gjigandeske,
me përpjesëtime europiane, që zgjati
më tepër se një çerek shekulli
dhe vuri përballë forcave vigane turke,
popullin tonë të vogël".

Skënderbeu, për të pasur mundësi që të mposhtet me luftë, ushtria aq e madhe osmane, nga trojet e Arbrit, Gjergji bëri një hap historik dhe vendimtar:
Më 2 mars të vitit 1444,
në Katedralen e Shënkollit të qytetit të Lezhës
u mbajt i pari Kuvend Kombëtar
i princërve dhe i fisnikëve shqiptarë
të shek. XV, disa prej të cilëve
kishin udhëhequr kryengritjet e viteve '30.
Në kuvend morën pjesë:
Skënderbeu, Gjergj Arianiti, Andrea Topia
(bashkë me dy djemtë e tij), Gjergj Stres-Balsha, Nikollë e Pal Dukagjini, Teodor Muzaka i Riu
(dhe disa pjesëtarë të tjerë të kësaj familjeje),
Lekë Zaharia, Pjetër Spani, (më katër djemtë e tij),
Lekë Dushmani, Stefan Gojçini (Cernojeviçi) etj.

Po, ashtu, për lexuesit e gazetës "Epoka e re", besojmë është me interes të përmendet, Sabri Godo,
shkrimtar, politikan, i cili thotë: "Skënderbeu është kthyer në legjendë dhe legjenda kthehet në mit. Por ka një të vërtetë të madhe, rreth figurës së tij. Ai e shkriu jetën në luftën kundër pushtimit turk dhe bëri çmos që këtë ta kthente në një luftë të të gjithë popujve të Ballkanit dhe më gjerë. Po të mos ishte kjo rezistencë e madhe, shqiptarët do të ishin kthyer në një popull të robëruar."

### NË VEND TË PËRFUNDIMIT

Vepra jubilare "600 VJET SKËNDERBE" e Riza Greiçevcit sjell edhe dy dhurata për lexuesit pa dallim moshë, feje, vendi ose race: Sjell një kapitull interesant: "Populli i këndon Gjergj Gjon Kastriotit" dhe ka zgjedhur vargje popullore që vetë populli i ka kënduar, këndon edhe sot, e do t'i këndojë denbabaden për shpatën, trimërinë, mençurinë, burrërinë e Gjergj Kastriotit. Dhe, fare në përfundim të librit, autori, Greiçevci, ka hartuar një kuiz diturie nga epopeja e epokës së Skënderbeut, por dhe nga historia kombëtare shqiptare, në formë garash, si një doracak për shkollarët e moshave të ndryshme, në shkolla shqipe.

E jashtëzakonshme

# Dërgohet në banesën e fundit me ekskavator



Një ish-shofer ekskavatori ka bërë udhëtimin e tij të fundit brenda kovës së një JCB. Len Fairhurst, 77 vjeç, i cili punoi në ndërtim dhe inxhinieri për dekada të tëra, vdiq pas një beteje të gjatë me pneumoni. Dëshira e fundit e tij ishte që arkivoli të transportohej në një gërmues si "mirënjohje" të karrierës së tij, ndërsa u shoqërua edhe me makina të tjera gjatë funeralit.

FOTO E DITES



Një flutur Papilio Machaon është parë në fushën përgjatë kufirit midis Izraelit dhe Rripit të Gazës. /AFP/

E rrallë

# Maçoku më i vjetër në botë feston 30-vjetorin e lindjes




Një maçok britanik, që mendohet të jetë më i vjetri në botë, ka festuar ditëlindjen. Rubble mbushi 30 vjeç më 1 qershor. Kafsha shtëpiake jeton me pronaren Michele Heritage, e cila i organizoi një festë me disa nga gjërat më të preferuara të tij dhe një tas me qumësht.

## BARSOLETA E DITËS



**I thotë shoku shokut:**
**- Na thuaj ndonjë gjë të re?**
**- Më ka tradhtuar gruaja, - i thotë ai.**
**- Unë të pyeta për ndonjë gjë të re.**

KINO ABC PRISHTINE

## Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

**Vetem gjate vikendit në ora 15:00**

### "AVENGERS: Infinity War" 3D,

Aksion/Aventurë/Fantazi; 2 orë 29 min

**Rolet:** Robert Downey Jr., Chris Hemsworth, Mark Ruffalo, Chris Evans, Scarlet Johansson, Tom Holland, Zoe Soldana, Josh Brolin, Chris Pratt, etj.

**Regjia:** Anthony Russo, Joe Russo







**Në ora 18:00**

### "ISLE OF DOGS"

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 41 min

**Rolet:** F. Murray Abraham, Bryan Cranston, Greta Gerwig, Jeff Goldblum, Akira Ito, Scarlett Johansson, Harvey Keitel, Frances McDormand, Bill Murray, Yoko Ono, Liev Schreiber, Fisher Stevens, Tilda Swinton, etj.

**Regjia:** Wes Anderson

**Në ora 16:00 dhe 20:00**

### "DEADPOOL 2" (R)

Aksion/Aventurë/Komedi; 1 ore 59 min

**Rolet:** Ryan Reynolds, Josh Brolin, Morena Baccarin, Julian Dennison, Zazie Beetz, T.J. Miller, Brianna Hildebrand, Jack Kesy, etj.

**Regjia:** David Leitch

**Gjate vikendit 19 dhe 20 maj, "DEADPOOL 2" do te shfaqet ne ora 13:00 dhe 20:00.**







**Në ora 22:00**

### "I FEEL PRETTY"

Komedi; 1 orë 50 min

**Rolet:** Amy Schumer, Michelle Williams, Rory Scovel, Emily Ratajkowski, Aidy Bryant, Busy Phillips, Tom Hopper with Naomi Campbell, Lauren Hutton, etj.

**Regjia:** Abby Kohn & Marc Silverstein

**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**



**DASHI**
Sot do të keni probleme me personat që kanë kërkuar mbështetjen tuaj për një projekt të caktuar. Nuk i keni mbështetur kur nevojitej.



**DEMI**
Duhet të tregoheni të kujdesshëm dhe të mos bini pre e provokimeve sot. Dikush po tenton t'ju nxjerrë keq në një situatë të caktuar.



**BINJAKËT**
Nëse do të tregoheni të vrazhdë sot nuk do të arrini asgjë. Mendoni që autoriteti vendoset me frikë, por keni zgjedhur rrugën e gabuar.



**GAFORRJA**
Filloni ditën me buzëqeshje sot, dëgjoni muzikë të mirë dhe takoni në një drekë miqtë tuaj. Kënaqësitë e vogla i japin kuptim jetës.



**LUANI**
Sot do t'ju duhet t'i lini vetëm personat tuaj të dashur për t'u marrë me një punë shumë të rëndësishme. Do ta ndjeni mungesën e tyre përgjatë gjithë ditës.



**VIRGJËRESHA**
Jeni shumë të ndjeshëm sot dhe në çdo moment jeni të gatshëm të ankoheni. Të gjitha gjërat duket sikur nuk shkojnë mirë dhe jeni nën presion.



**PESHORJA**
Nuk jeni person që shkoni pas thashethemeve megjithëse dëgjoni shumë. Pozita në të cilën ndodheni aktualisht ju bën shënjestër të personave të tjerë.



**AKREPI**
Nëse doni të reflektoni mbi ofertat profesionale që ju janë bërë së fundmi, sot është dita e duhur. Do të bëni një zgjidhje disi të rrezikshme.



**SHIGJETARI**
Shumë mendime të dhëna në tym ju kanë bërë më konfuz seç ishit. Doni të qetësoheni, shkoni në një vend që për ju është ideal.



**BRICJAPI**
Sot jo shumë persona do të arrijnë të kuptojnë atë që doni të thoni. Për këtë shkak do të ketë debate të forta midis jush dhe një të linduri të shenjës së Peshqve.



**UJORI**
Nëse nuk doni të krijoni debat me personin e zemrës mos hapni sot një temë bisede që do t'ju shqetësonte të dyve.



**PESHQIT**
Mos kini drojë të ballafaqoni disa persona sot. Kanë folur për çështje që nuk ju takojnë aspak dhe është mirë ballafaqimi.

# I dashuri i Ariana Grandes bën dy tatuazhe për të



Pete Davidson e bëri të përhershme lidhjen me këngëtaren Ariana Grande, meqë në trupin e tij i vendosi dy tatuazhe inspiruar nga ajo. Komediani 24-vjeçar i emisionit "Saturday Night Live" e zgjodhi formën e veshëve të lepurit me ngjyrë të zezë për ta vendosur prapa veshit të tij. Për këtë vepër artistike ai u frymëzua nga kopertina e albumit të Arianas "Dangerous



# Bella dhe The Weeknd konfirmojnë se janë kthyer bashkë



Modeluesja Bella Hadid dhe këngëtari The Weeknd kanë konfirmuar se janë kthyer sërish në krahët e njëri-tjetrit. Dyshja kishin qenë në lidhje me njëri-tjetrin për 18 muaj, por kishin vendosur të ndahen në nëntor të vitit 2016. Ata u panë së bashku duke shëtitur në Paris këtë të enjte, ndërkaq ishin parë në shoqërinë e njëri-tjetrit edhe sivjet edhe në Kanë dhe Coachella.

# Sofia Richie ndahet nga i dashuri, zbulohet arsyeja




Me sa duket gjithçka ka mbaruar mes Sofia Richie dhe Scott Disick, pas pothuajse një vit në lidhje. Modeluesja 19-vjeçare thuhet se është ndarë nga aktori 35-vjeçar pasi ai u kap me një femër tjetër, raporton "People". Në fillim të kësaj jave, Scott është parë duke kapur dorën e një femre misterioze, ndërkohë që ai ishte në festën e albumit të Kanye Westit.









# Partnerja e De Geas uron ardhjen e qershorit me foto plot ngjyra

Partnerja e portierit të Manchester Unitedit dhe përfaqësueses së Spanjës, Edurne, e nis qershorin me disa foto sensuale në "Instagram". Këngëtarja dhe prezantuesja ka thuajse një milion ndjekës në këtë rrjet social, kështu që çdo postim i saj bëhet viral brenda pak minutash. Artistja spanjolle duket shumë e lumtur në krah të portierit 27-vjeçar, që në çdo sesion merkatoje diskutohet për një kalim të mundshëm në radhët e Realit të Madridit.

# Fejohet ish-burri i Meghan Markle

Tani që Meghan Markle është martuar, është koha që ish burri i saj, Trevor Engelson, ta bëjë pothuajse të njëjtën gjë. Sipas "Us Weekly", Engelson është fejuar me të dashurën e tij, Tracey Kurland. Ashtu si Markle, kjo do të jetë martesa e dytë për Engelson. Të dy ishin të martuar për rreth shtatë vjet.



# Kroaci, turizëm dhe ndërtime pa leje në kurriz të natyrës




Liqenjtë Plitvice, parku më i vjetër i Evropës Juglindore, vendi ku është xhiruar filmi i famshëm Winnetou janë në rrezik, sepse shtimi i turistëve po sjell me vete edhe shtimin e ndërtimeve ilegale

Ambientalisti Ivica Jandric jeton afër lieqeveve dhe vjen shpesh këtu. Atij i pëlqen shumë ky vend me ujvara. "Ky është një nga vendet më të bukura të planetit, monument natyre, që mbrohet nga UNESCO. Deri para pak kohësh ujrat këtu kanë qenë më të pastrat në botë. Por, ndërtimet pa leje kanë shkaktuar shumë dëme dhe këtu nuk mund të lahesh më ose të pish ujë." – tregon Ivica. Ndër të tjera mungojnë edhe kanalizimet.

Liqenet ndodhen në rrezik akut, sepse këtu vijnë çdo vit dy milionë turistë. UNESCO ka kërcënuar se do ta heqë statusin e trashëgimisë botërore, sepse ky status nuk jepet për vende ku vijnë masa të tilla njerëzish.

### Qeveria hesht

Ndër të tjera mungojnë edhe kanalizimet, dhe pislléku kullon i pafiltruar në tokë dhe përfundon në Liqenin e Plitvices. Qeveria i ka bërë analizat e ujit të liqenit, thotë Ivica, por rezulatet nuk janë bërë publike. Sepse asnjë nuk duhet ta marrë vesh se uji i Liqenëve të Argjendë nuk është më i pishëm.

Kryetari i Bashkisë në komunën e liqenëve Plitvice, Ante Kovac, na siguron se problemi është bërë më në fund i ditur, dhe e shtyn përgjegjësinë tek qeveria në Zagreb. "20 vjet me radhë kurrkush nuk u kujdes për ujërat e zeza. Tani ora është 12 pa 5. Shteti e ka kuptuar se Plitvice ka rëndësi kombëtare dhe jo vetëm lokale dhe nuk duhet të humbasim kohë."





### Turistë dhe ndërtime

Por ende në parkun kombëtar vazhdojnë ndërtimet. Shtëpitë ngrihen si kërpudhat pas shiut dhe shumë leje ndërtimi janë të dyshimta. Dhe me shtimin e shtëpive edhe numri i turistëve është në rritje.

Koha nuk pret dhe Ivica dhe kolegët e tij do vazhdojnë të luftojnë. Ne veteranët jemi rritur këtu, thotë ai, dhe jemi të vendosur, ta mbrojmë këtë pasuri natyrore.

*(gazeta-Shqip.com0 / DW*

# Takimet dhe mbledhjet e planifikuara na bëjnë më pak produktivë

Mbledhjet dhe në përgjithësi të gjitha takimet fikse na bëjnë më pak produktivë. Pse? Ne nuk mund ta shfrytëzojmë si duhet kohën e lirë që kemi në dispozicion para se të fillojmë ose në hapësirën midis një angazhimi dhe një tjetri. Kjo është zbuluar nga një studim i 'Ohio State University's Fisher College of Business', botuar në Journal of Consumer Research. Në një seri prej tetë eksperimentesh, si në laborator dhe në jetën reale, studiuesit zbuluan se koha e lirë duket më e shkurtër për njerëzit, kur është vendosur në kalendarin e tyre një detyrë ose një takim.

"Ne mendojmë se mund të dalë diçka, që ne mund të kemi nevojë për ndonjë kohë shtesë, edhe kur nuk ka nevojë. Kështu që bëjmë më pak me kohën që na disponon", thekson Selin Malkoc, bashkautor i studimit.

Në një eksperiment në internet, disa pjesëmarrësve u ishte thënë të imagjinonin një shok që vinte në takim një orë më vonë dhe se gjithçka ishte gati, ndërkohë që nuk kishin as plane për në mbrëmje. Gjithkush u pyet se sa minuta "objektivisht" ata mund të kishin kaluar duke lexuar orën tjetër dhe sa minuta "subjektivisht" mund të kalonin leximin gjatë të njëjtës orë.



Doli në pah se ata që kishin ofruar skenarin e pritjes për një mik mendonin se kishin 40 minuta në dispozicion, krahasuar me 50 nga ata që nuk kishin programe. Në një test tjetër, të kryer në jetën reale, pjesëmarrësit preferuan të merrnin pjesë në një eksperiment me një kohëzgjatje më të vogël, edhe pse më pak të paguar në orën përpara angazhimit të tyre të planifikuar, ndërsa një e treta, nga 158 studentë, doli në fund se ata që janë në gjendje të bëjnë më shumë aktivitete, nuk kanë në kokë takime të planifikuara.

*(gazeta-Shqip.com)*

# "Boom" i miliarderëve në botë, pasanikët janë 2.754!

Kjo është zbuluar nga "The Wealth-X billionaire census 2018", një raport që regjistron super-të pasurit ndërkombëtarë



Numri i miliarderëve në botë vazhdon të rritet dhe në 2017 pasanikët u rritën me 357 njësi, duke arritur një shifër rekord prej 2.754. Kjo është zbuluar nga edicioni i pestë i "The Wealth-X billionaire census 2018", një raport që liston miliarderët që banojnë në Tokë. Në 12 muajt e fundit popullsia e super-të pasurve është rritur me 14.9% dhe krenohet me një aset total prej 9.2 trilionë dollarëve.

### Raporti

Sipas asaj që lexohet në raport, në vitin 2017 ka pasur një "përmirësim të ndjeshëm" në pasuritë e miliarderëve: "Edhe pse vitin e kaluar ka pasur një dozë të ndjeshme të trazirave politike, thotë Winston Chesterfield, drejtor i 'Wealth-X', kompani e specializuar në vlerësimin e aseteve individuale që çdo vit publikon kërkime mbi super-të pasurit, – performanca e jashtëzakonshme e tregjeve të kapitalit dhe e ekonomisë globale në përgjithësi kanë dhënë fitime të fuqishme në sektorin e financave, të mallrave, të teknologjisë dhe të industrisë. Në një mjedis gjeopolitik që ndryshon me shpejtësi, ndikimi mbi ekonominë botërore të këtij grupi më ekskluziv të njerëzve vazhdon të rritet".

### Të dhënat statistikore

Shtetet e Bashkuara janë konfirmuar si vendi me popullsinë më të madhe të miliarderëve. Në të vërtetë, jashtë shtetit numërohen 680 pasanikë me një rritje prej 10% krahasuar me vitin 2016. Numri i super-të pasurve po rritet me shpejtësi edhe në Kinë. Në ish-Perandorinë Qiellore janë 338 miliarderë, me një rritje prej 36% në 12 muaj. Më poshtë janë Gjermania, India, Zvicra, Rusia, Hong Kongu dhe Mbretëria e Bashkuar. Njeriu më i pasur në botë është amerikani Jeff Bezos me një pasuri prej 133 miliardë dollarësh (vetëm muajin e kaluar padroni i Amazon ka fituar edhe 12 miliardë dollarë). 10 më të pasurit në botë kolektivisht zotërojnë një pasuri prej 660 miliardë dollarësh. Në vitin 2017 ka pasur gjithashtu një bum të grave super të pasura: popullsia femërore miliardere është rritur me 18% dhe ka arritur 321 njësi, krahasuar me një rritje prej 14% në numrin e meshkujve. Megjithatë, gratë përfaqësojnë vetëm 11.7% të super-të pasurve ndërkombëtarë. *(gazeta-Shqip.com)*

# Verë, 8 këshilla për të kursyer gjatë pushimeve

Kënaquni në maksimum, por duke ditur se si të kurseni. Volagratis.com na jep tetë këshilla për pushimet verore (që janë gjithmonë të vlefshme).



**1.Verë në qytet:** Gjatë muajve të verës, udhëtimet e biznesit janë më të ulëta në qytete të tilla si Londra, Parisi ose Madridi. Kjo e bën muajin gusht një kohë të shkëlqyer për të marrë një pushim të shkurtër, duke prenotuar hotelin e fluturimit dhe gjithashtu të kurseni para.

**2.'Mix dhe Match':** Ju nuk duhet domosdoshmërisht të fluturoni me të njëjtën linjë ajrore duke rezervuar vajtje-kthim. Kombinimi i disa kompanive në fakt do të zvogëlojë shpenzimet.

**3.Paketa perfekte:** Dy është më mirë se një: duke prenotuar paketën që përfshin si fluturimin ashtu edhe hotelin ju mund të kurseni deri në 30% mbi çmimin total.

**4.Fluturime me ndalesë ose aeroport jetër:** Nëse nuk keni nxitim për të arritur në destinacionin tuaj, merrni parasysh fluturimet me një ndalesë, ato shpesh janë më të lira. Gjithashtu hidhni një sy në fluturimet në destinacionin e zgjedhur duke kërkuar nëpër aeroporte të ndryshme, jo vetëm aty ku e keni më të përshtatshme dhe afër! Nëse jetoni pranë një shteti tjetër, por lehtësisht të arritshëm, kontrolloni aeroportet në atë zonë: mund të gjeni oferta që do t'ju ndihmojnë të kurseni para!

**5.Ditët e duhura:** Zgjidhni me kujdes ditët e javës që do të udhëtoni: më mirë e shmangni fundjavën! Të martën, të mërkurën dhe të enjten janë ditët më të ngarkuara, që përkthehet në mundësinë e gjetjes së çmimeve më të lira për paketat e fluturimit +.

**6.Fleksibiliteti:** Të jesh fleksibël është një mantë për udhëtarin që dëshiron të kursejë para: ata që nuk janë të lidhur me ditë specifike të nisjes dhe kthimit mund të shmangin datat më të njohura dhe të identifikojnë ofertat më të përshtatshme.

**7.Pesë yjet me buxhet të ulët:** A keni ardhur për të prenotuar në minutën e fundit? Atëherë shpërbleheni me një paketë hotelesh 4 * ose 5 * fluturimi: përmes Volagratis.com hotelet Top Secret® mund të mbushin dhomat e tyre deri në minutën e fundit, duke ju lejuar të merrni dhoma luksoze me një çmim deri në 40% më të ulët.

**8.Zgjidhni destinacionin e duhur:** Zgjidhja për të kursyer para pa hequr dorë nga kënaqësia e pushimeve është të zgjidhni destinacionin tuaj të verës me këto kritere: për shembull, vendet në të cilat kursi i këmbimit është i favorshëm dhe siguron kursime më të mëdha kur bëhet fjalë për të ngrënë dhe për të pirë. *(gazeta-Shqip.com)*




Sport

QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

| PROGNOZA SPORTIVE | SLOVAKIA - MOROCCO | 1 | ITALY - HOLLAND | GG | JONKOPING SODRA -VASBY UNITED | 1 |
|---|---|---|---|---|---|---|

# Rexha: Marrëveshje nuk kam me asnjë skuadër, bisedime po

Sulmuesi Kastriot Rexha ka thënë për "Epokën e re" se nuk ka asnjë marrëveshje të arritur me ndonjë klub, por vetëm bisedime. Ai synon të luajë me Dritën në Ligën e Kampionëve dhe më pas do ta marrë vendimin se ku do të luajë në sezonin e ardhshëm. Disa skuadra vendore, një nga Maqedonia dhe disa nga Shqipëria, po e kërkojnë autorin e 14 golave në Superligë




EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 3 QERSHOR - Një nga sulmuesit më të mirë në edicionin e sapopërfunduar në elitën e futbollit të Kosovës, Kastriot Rexha, ka konfirmuar të dielën për "Epokën e re" se nuk ka asnjë marrëveshje me ndonjë skuadër tjetër, por vetëm bisedime. Ai nuk e ka përjashtuar mundësinë që të mbetet pjesë e Dritës edhe në edicionin ri. "Unë ende jam duke u stërvitur me Dritën dhe kemi filluar të përgatitemi për ndeshjet në Ligën e Kampionëve. Pra, marrëveshje nuk kam me asnjë skuadër, bisedime po. Aktualisht kam kontratë që me lidh me Dritën deri në përfundim të raundit të parë kualifikues të cilën e kam nënshkruar një vit më parë dhe do ta respektoj, pavarësisht se çfarë do të vendosë Drita", ka thënë Rexha.
Sulmuesi kryesor që e udhëhoqi Dritën drejt titullit të kampiones ka thënë se ofertat janë të shumta si nga klubet vendore, po edhe nga Shqipëria. "Kam shumë oferta dhe nuk kam dëshirë t'i jap emrat e skuadrave që më kanë kontaktuar. Krejt çfarë mund të them tash është se janë disa skuadra nga Superliga e Kosovës dhe ajo e Shqipërisë. Një ofertë e kam edhe nga një skuadër nga Maqedonia dhe një në Ligën e Parë këtu në Kosovë. Jam në bisedime edhe me skuadrën e Dritës për mundësinë e vazhdimit edhe për kampionatin e ardhshëm", ka deklaruar ai.
Skuadrat që e kanë kontaktuar sulmuesin prishtinas në Kosovë janë Feronikeli, Prishtina dhe Besa. Rexha në të kaluarën ka luajtur për Prishtinën, Besën, Trepçën '89, Hysin, 2 Korrikun dhe Vllazninë e Shkodrës.

### Fazliu lë Dritën për Feronikelin

Ndryshe nga Kastriot Rexha, Astrit Fazliu nuk ka hezituar shumë për ta lënë skuadrën e Dritës me të cilën është shpallur kampion në Superligë. Fazliu që ka bërë karrierë edhe në Shqipëri e Maqedoni të shtunën ka nënshkruar kontratën dhe më pas është prezantuar nga Feronikeli. "Falënderoj ekipin e Dritës për një vit që kaluam bashkë, kurse qëllimin që e kishim për të sjellë një trofe në Dritë ia arritëm. Falënderoj stafin teknik, kryesinë e klubit. Një falënderim i veçantë shkon për tifozët 'Intelektualet' të cilët na mbështeten në çdo ndeshje", ka thënë Fazliu.

## SHKURT

### Prishtina dhe Kutllovci vazhdojnë me Vushtrrinë

Futbollistët Amir Prishtina dhe Kujtim Kutllovci kanë vazhduar marrëveshjet me skuadrën e Vushtrrisë edhe për edicionin e ardhshëm 2018/2019. Klubi i Vushtrrisë i ka falënderuar lojtarët në fjalë për gatishmërinë dhe vullnetin që të jenë pjesë e skuadrës, kurse synimi i përbashkët është inkuadrimi në Superligë.

### Fationa dhe Erza, të suksesshme në Austri

Xhudistja e re, Fationa Kasapi, është shpallur nënkampione ballkanike. Deri te kjo medalje Fationa arriti pas tri fitoreve dhe një humbjeje. Ndërsa Erza Muminoviq ka siguruar medaljen e argjendtë në Leibnitz të Austrisë në kuadër të Kupës Evropiane për juniorë, e vlefshme për ranglistën botërore.

### Hysaj: Largimi i Sarrit, lajm jo i mirë për mua

Elseid Hysaj ka pranuar se largimi i trajnerit Sarri nga Napoli nuk është një lajm i mirë për të, duke qenë se kishte vite që punonte me teknikun 59-vjeçar. "Largimi i Sarrit nuk është aspak një lajm i mirë për mua. Kam gjashtë vjet që kam punuar me atë njeri. Gjithsesi, Napoli ka bërë një zgjedhje të mirë me Ancelottin, i cili është një trajner i shkëlqyer. Të gjithë e dimë se sa tituj ka fituar ai në karrierën e vet. E ardhmja? Tani ka vetëm zëra, unë nuk di asgjë. Thjesht kam lexuar ato që janë shkruar", ka pohuar Hysaj.

## Krasniqi: Dua të bëhem kampion bote

PRISHTINË, 3 QERSHOR - Boksieri shqiptar nga Juniku, Haxhi Krasniqi, e ka fituar titullin e kampionit të Evropës EBU pasi e mposhti rusin Stanislav Kashtanov në një meç të zhvilluar në Gjermani. Krasniqi dominoi duke i dhënë goditje të forta kundërshtarit të të tij pothuajse në çdo rund nga 12 sa zgjati meçi. Pas këtij triumfi, ai do të ketë rastin ta kërkojë titullin e kampionit të botës, një brez të cilin e kërkon dhe për të cilin po punon shumë në vitet e fundit 31-vjeçari, i cili edhe një herë bëri krenar të gjithë shqiptarët. "Shumë kanë menduar se lufta ime ka mbaruar. Nuk i njoh kufijtë e mi. Jam i gatshëm të bëj edhe shumëçka dhe dua të bëhem kampion bote", ka thënë Krasniqi për "Sky Sport News HD".



## Lorenzo triumfoi në Itali

ROMË, 3 QERSHOR - Jorge Lorenzo me Ducatin fitoi Çmimin e Madh të Italisë. Nga pozicioni i parë u nis italiani Valentino Rossi, por "Doktori" nuk arriti ta ruante këtë pozicion, duke e humbur që në start. Italiani u rendit i treti, duke fituar një vend në podium në shtëpinë e vet. Vendi i dytë u rezervua për shokun e skuadrës së Lorenzos, Andrea Doviciozo. Ndërkohë, kampioni i botës në fuqi, Mark Markez, me Hondan e tij zhgënjeu. Ai rrëshqiti duke dalë nga pista, ndërkohë që ishte i dyti. Në fund e mbylli garën i 16-ti. Megjithatë, ende ruan kreun e renditjes.



# Shqipëria pëson humbje të thellë nga Ukraina

TIRANË, 3 QERSHOR - Shqipëria, pas humbjes nga Kosova, pësoi edhe një tjetër humbje të thellë në ndeshjen miqësore. Kuqezinjtë u mposhtën në Francë nga Ukraina (1-4). Kuqezinjtë kanë shpërdoruar dy raste në minutat e para të takimit me Lenjanin dhe Mavrajn, për të cilat janë ndëshkuar jo pak, por plot tre herë në pjesën e parë. Golat i shënuan Yevheniy Konoplyanka (31) dhe Andriy Yarmolenko (36, 45). Ndonëse vetëm me një tjetër gol nga ana e ukrainasve, pjesa e dytë ka shfaqur kuqezinjtë edhe më keq në organizim jo vetëm në mungesë totale të aksioneve ofensive, por edhe në fazën difensive. Të shumta ishin rastet për shënim në favor të Ukrainës por, fatmirësisht, për Shqipërinë, fati dhe cilësitë e Berishës kanë ndalur goleadën, duke lejuar vetëm një gol në minutën e fundit. Ndërkohë, në të 89' ishte Ndoj që shënoi golin e nderit për Shqipërinë.



## Brazili mposhti Kroacinë

Brazili e ka mposhtur në miqësore Kroacinë me rezultat 2-0. Ndeshja e zhvilluar në "Anfield" u takoi brazilianëve, të cilët fituan me dy golat e shënuara në pjesën e dytë. Ylli i PSG-së, Neymar, realizoi në minutën e 69, kurse Roberto Firmino në minutën e fundit e vulosi rezultatin final 2-0. Të dyja këto kombëtare do të marrin pjesë në Kupën e Botës "Rusi 2018".

# Hamiltoni: Vetteli dhe Ricciardo janë të frikshëm

LONDËR, 3 QERSHOR - "Është e qartë që këtë sezon do të jetë një sfidë treshe për titullin dhe personalisht e adhuroj këtë situatë", ka deklaruar sot Lewis Hamiltoni, kampioni i botës në fuqi në Formula 1. Piloti i Mercedesit ka deklaruar se, përveç Sebastian Vettelit me Ferrarin, pretendent është edhe piloti i Red Bullit, Daniel Ricciardo. Në gjashtë garat e para sezonale, këta tre pilotë kanë fituar secili nga dy gara dhe vetëm fakti që Hamiltoni ka qenë më konstant i ka dhënë atij kryesimin e Botërorit. "Është sfida më e madhe që kam pasur në karrierën time dhe na pëlqen edhe si skuadër. Më pëlqen edhe fakti që më duhet të gërmoj në aftësitë e mia teknike për të zbuluar më të mirën dhe të mësoj sa më shumë për të fituar. Punojmë fort të gjithë për ta pasur makinën më të mirë të mundshme në fundjavë, për të qenë të shpejtë të shtunën në provat zyrtare dhe konstantë të dielën në garë. Gjëra ndryshe që na kanë munguar, ndaj po argëtohem shumë", ka deklaruar Hamiltoni. Megjithatë, piloti britanik i Mercedesit besob se makina italiane është ende më e shpejta. "Ferrari është ende makina më e fortë e këtij Botërori, një makinë që deri më tani ka funksionuar mjaft mirë. Edhe pse ne kemi punuar fort dhe jemi më mirë nga parashikimet, sërish 'kokëkuqja' është një hap para nesh. Ndaj do të jetë një betejë e fortë mes Ferrarit, Mercedesit dhe Red Bullit, që ka karakteristika të veçanta dhe përshtatet mjaft mirë me pistat", ka shtuar Hamiltoni.




## SHKURT

### Shaqiri: Dua të largohem nga Stoke

Futbollisti shqiptar Xherdan Shaqiri ka konfirmuar se do të largohet nga Stoke City skuadër që nuk arriti të mbijetojë në Premierligë. Ish-lojtari i Bayern Munchenit dhe Interit ka thënë se dëshira është ta vazhdojë karrierën në Premierligë, duke mos përjashtuar edhe ligat e tjera. "Nuk është sekret se dua të largohem nga Stoke. Mendoj se liga angleze është e duhura për mua. Do të doja të qëndroja në Angli, por nuk përjashtoj asgjë. Është Liga më e mirë me lojtarët më të mirë", ka thënë Shaqiri për "Aargauer Zeitung".

### CR7 mbetet jashtë 11-shës së Ronaldos

Luiz Nazario De Lima Ronaldo e ka zbuluar 11-shën më të mirë në të gjitha kohët në futboll. Befasia më e madhe në këtë formacion është mungesa e Cristiano Ronaldos, i cili ka fituar pesë herë "Topin e Artë". Në portë është Buffoni, kurse krahët e mbrojtjes përbëhen nga brazilianët Carlos dhe Caffu, kurse në qendër janë Cannavaro dhe Maldini. Në mesfushë janë Pirlo, Zidane, kurse sulmi përbëhet nga katër futbollistë: Pele, Maradona, Messi dhe pikërisht Ronaldo (Fenomeni).

### Werneri në Bayern si zëvendësues i Lewandowskit

Timo Werneru pritet të jetë zëvendësues i Robert Lewandowskit në Bayern Munchen. Lajmin e ka konfirmuar "Bild". Lewandowski është i vendosur të largohet nga Bayerni në këtë afat kalimtar, kurse Werneri duket zëvendësim ideal për polakun. Problemi i vetëm për transferimin e sulmuesit gjerman mund të jetë shifra e madhe prej 114 milionë eurosh që e kërkon Leipzigu.

### Balotelli kërkohet nga Marseille

Sulmuesi i Kombëtares së Italisë, Mario Balotelli, pas formës së mirë në fanellën e Nicës, ka zgjuar interesimin e shumë klubeve evropiane. Fillimisht Roma, Napoli dhe Parma kanë treguar interesim për Balotellin, kurse këtë gare i është shtuar edhe Marseille. Drejtuesit e kësaj skuadre e kanë parë në vazhdimësi nga afër sulmuesin italian dhe dëshira e tyre është ta kenë në skuadër për sezonin e ri. Balotelli ka luajtur edhe për Manchester Cityn, Milanin, Interin dhe Liverpoolin.

### Mourinho paralajmëron surpriza në Botëror

Jose Mourinho bëri një pasqyrë të botërorit që nis këtë muaj në Rusi, duke renditur edhe skuadrat që, sipas tij, do të lënë shenjë. Tekniku i Manchester Unitedit i dha virtualisht Argjentinës dhe Portugalisë, epitetin e surprizave të kampionatit, ndërsa personalisht e shtyu edhe disa vjet, debutimin në një seleksion kombëtar. "Botërorët më emocionojnë shumë pasi nuk janë thjesht futboll. Janë ngjarje njësoj si olimpiadat, që kanë impakt të pabesueshëm në nivel social. Edhe pse personalisht mendoj se nuk luhet futbolli më i mirë, pasi në klube ka më shumë kohë, prapë është emocionues. Mendoj se Argjentina dhe Portugalia do të rezervojnë surpriza, pasi Messi dhe Ronaldo janë të aftë të bëjnë më shumë sesa seleksionet respektive. Portugalia fitoi Evropianin dhe është e aftë për çdo gjë. Më pas kemi dhe Brazilin, me mbrojtje të fortë dhe talentë", ka thënë Mourinho.

| | | | | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
|  | | | | | | Autor: GAZMEND MORINA | FATKEQËSI E MADHE, KOB | PJESË E ILIRISË | SËPATË E VOGËL | FAZAT | HIT NGA GRUPI MUZIKOR “NRG BAND” | BASHKËT. | PËREMËR PRONOR | RRETHI QË VIHET NË NJË BOSHT DHE QË RRO-TULLOHET | SHKRIMTARJA KADARE | PERANDOR ROMAK | EPOKA E RE |
| | | | | | | AKTORJA ANGLEZE NË FOTO | | | | | | | | | | | RAMADAN AVDIU |
| | | | | | | GJENDJE PLOGËSHTIE SHPIRTËRORE | | | | | | BOJAXHI | | | | | |
| | | | | | | VIGAN | | | | | | I THAVA / RAPSODI HASHIM …. | | | | | |
| | | | | | | QULL I TRASHË ME MIELL MISRI | | | | | | | ASSOCIATION NEWS ONLINE / SHTET NË AMERIKË | | | | ISH FUTBOLLISTI ….. RRAKLI (shq.) |
| | | | | | | EPOKA E RE | IPSVICH / QYTET I MADH NË GJERMANI | | ARSENAL / LLOJ MINERALI (shq.) | | ANITA KOSUMI / KLUB FUTBOLLI NË SPANJË | | | TENISTJA KURNIKOVA / SHTIRËSI | | | |
| | | | | | | ZANORE | | ZBUKUROJ ME STOLI / ARBEN MALAJ | | | | | | | ILION LIKA / SMIRË | | |
| | | | | | | NJË E HAPUR E NJËRËS KËMBË PARA | | | | KËNGËTARI ….. ARIFI / DESPOTI | | | | | | TOTENHAM / KËNGËTARJA E FAMSHME …… CAREY (shqip.) | |
| EPOKA E RE | KEQTINGË-LLIM | ZAKON, TRADITË | AKTORJA E FAMSHME ……. CRUZ (shqip.) | ARMATA REPUBLIKANE IRLANDEZE (shk. orgj.) | VOZË E MADHE DRURI QË SHËRBEN PËR TË MBAJTUR DJATHË | E PESHOVA / ERMELINDA MEKSI | | | | | | KRYEHOXHA / AKTORJA AMERIKANE … FARIS | | | | | |
| KOMANDANTI I NJË ANIJEJE | | | | | | | | LUMË I MADH NË HUNGARI / TREGU | | | | | NJË PLANET | | | | |
| ANËTARËSIM NË NJË ORGANIZATË | | | | | | | MJET I VOGËL KUZHINE / KURIFI, CAKU | | | | | | DAFINË (shq.) / KAFSHË GJITARE BREJTËSE | | | | |
| AKTORI TURK IMIRZALIOGLU | | | | | | NOTË MUZIKORE / KORNIZË | | | METODË STUDIMI / BASKETBOLL-ISTI TURK OMER | | | | | | | | NJËRA NDËR TRI GJINITË KRYESORE TË KRIJIMTARISË LETRARE |
| OVERLAND TRAIL ELEMENTARY | | | | SHTET FEDERAL NË SHBA / NJË PREJ FIGURAVE STILISTIKE | | | | | | | | EDI MARFI / BERAT LUZHA | | | “JEMENI” / UDHËHEQËSI I NJË PARTIE | | |
| BASHKËT. | | I LARMI / MODELJA KRASNIQI | | | | | | | | | BEDRI PEJANI / ISH PORTIERI GJERMAN OLIVER | | | LAMBERT ACADEMIC PUBLISHING / KËNGËTARJA …. ISTREFI | | | |
| GAZ QË PËRDORET PËR TË PASTRUAR MIRË PLAGËT | | | | | KËNGËTARJA …. KONÇI / FILMI I PARË SHQIP | | | | | AKTORI HOLLIVUDIAN XHORXH ….. / FILOZOFI GJERMAN IMANUEL | | | | | | ZANORE / I FILLOVA | |
| RUBË, MARAMË (sh.shq.) | | | | | | AKTORJA ….. KURTI / TAJVANI, INDONEZIA | | | | | | TENISTI I FAMSHËM ENDI ….. / AQ SA DUHET (krah.) | | | | | |
| INDIUM | | | MBARËSIA / GATESA | | | | | PUSIA | AGENCIA NACIONAL TRANSITO / BËRJA MË I RI | | | | AKTORJA AMERIKANE …. SOFER / FUTBOLLISTI RAFAEL ….. (Real Madrid) | | | | |
| EPOKA E RE | TË DHËNËT SHPIRT, HEKË / FAQJA E PJERRËT E NJË MALI | | | | | | FOSFOR, RADIUM, AZOT / EMINE (perkdh.) | | | | DËMTIM I NJË MAKINE GJATË PUNËS / ENI LENOKS | | | | | | NITROGJENI |
| BASHKËT. | | TOKA E BUKËS / AKTORI ZHITOPOTOKU | | | | SKUQJA E LËKURËS NGA ZGJERIMI I KAPILARËVE / AKTORI AM. SANDLER | | | | | | | | REGJISORI … QOSJA / KASOLLE PËR KAFSHËT | | | |
| SHPEND ME QAFË TË GJATË E ME SQEP TË MADH | | | | | “ASHTU QOFTË” / KËNGËTARJA … KOÇI | | | | | NJOLLA / KOHË | | | | | AGIM ZAJMI / PATRIOTI BOLETINI | | |
| SHOUMENI … KRASTA | | | | BOTIM / ELIZABETH TAYLOR | | | | | | | SHAKA, SHPOTI / “RISANI” | | | | | ZANORE / EDI RAMA | |
| PËRSHËNDE-TJE ALLATURKA NË SHENJË NDERIMI TË THELLË | | | | | | | HYJNI E DASHURISË (mit. romake) / INTER | | | | | FEMRAT E SAPOMART-UARA / NANCY | | | | | |
| KOPJIMI | | | | | | | | RRUGËTIMI I TRENAVE | | | | | | | | | |

REPUBLIKA E KOSOVËS – ZYRA E PRESIDENTIT
REPUBLIC OF KOSOVO – OFFICE OF THE PRESIDENT
REPUBLIKA KOSOVO – KANCELARIJA PREDSEDNIKA

*SEKRETARIATI I KËSHILLIT KONSULTATIV PËR KOMUNITETE*
*SEKRETARIAT OF THE CONSULTATIVE COUNCIL FOR COMMUNITIES*
*SEKRETARIAT KONSULTATIVNOG VEĆA ZA ZAJEDNICE*

Në bazë të nenit 22 të Statutit të Këshillit Konsultativ për Komunitete, të shpallur përmes dekretit Nr. DNJ – 02 - 2017 të Presidentit të Republikës së Kosovës, Sekretariati i Këshillit Konsultativ për Komunitete

## SHPALL KËTË NJOFTIM PUBLIK

- Ftohen organizatat përfaqësuese të komuniteteve të paraqesin kërkesën për aplikim, listën e kandidatëve për anëtarë në Këshillin Konsultativ për Komunitete dhe listën e delegatëve me të drejtë vote.
- Ftohen personat që i takojnë komuniteteve jo shumicë të Kosovës të aplikojnë në mënyrë individuale për anëtarë në Këshillin Konsultativ për Komunitete.

**Afati i fundit për aplikim**:
Aplikacionet duhet të dorëzohen në Sekretariatin e Këshillit deri më **04.07.2018, 16:00.** Aplikacionet e dorëzuara pas këtij afati, nuk do të pranohen.

**Si të aplikoni:**
Aplikacionet mund të dërgohen me:
- Postë elektronike
- Dorëzim fizik dhe
- përmes postës së rregullt në adresën e mëposhtme:

**Ndërtesa e Kuvendit, Zyra e Presidentit të Republikës së Kosovës, Sekretariati i Këshillit Konsultativ për Komunitete, Zyra N-321, Prishtinë, 10000, Kosovë**

Për të shkarkuar aplikacionet ju lutem vizitoni faqen e internetit të Këshillit Konsultativ për Komunitete (në gjuhët zyrtare): www.ccc-rks.net

REPUBLIKA E KOSOVËS – ZYRA E PRESIDENTIT
REPUBLIC OF KOSOVO – OFFICE OF THE PRESIDENT
REPUBLIKA KOSOVO – KANCELARIJA PREDSEDNIKA

*SEKRETARIATI I KËSHILLIT KONSULTATIV PËR KOMUNITETE*
*SEKRETARIAT OF THE CONSULTATIVE COUNCIL FOR COMMUNITIES*
*SEKRETARIAT KONSULTATIVNOG VEĆA ZA ZAJEDNICE*

Kosova Cumhuriyeti Cumhurbaşkanın İH – 02 – 2017 Nolu Kararname aracılığıyla yayınlanan, Topluluklar için Danışma Konseyi Tüzüğü'nün 22. maddesi uyarınca, Topluluklar için Danışma Konseyi Sekreteryası

## BU KAMU BİLDİRİSİNİ YAYINLAR

- Toplulukların temsilci kuruluşları, başvuru talebini, Topluluklar için Danışma Konseyi'nde üye için aday listesini ve oy hakkı ile delegelerin listesini sunmaya davet edilirler.
- Kosova'da çoğunluk olmayan topluluklara ait kişiler, Topluluklar için Danışma Konseyi'nde üye için bireysel şekilde başvurmak için davet edilirler.

**Tüm başvurular için son tarih**:
Başvurular, **04.07.2018** tarihi, saat **16:00'ya** kadar Konsey Sekreteryası'na gönderilmelidirler. Bu tarihten sonra yapılan başvurular kabul edilmeyeceklerdir.

**Nasıl başvurabilirsiniz:**
Başvurular aşağıdakiler aracılığıyla gönderilebilir:
- E-posta
- Fiziksel teslimat ve
- Aşağıdaki adreste normal posta ile:

**Meclis Binası, Kosova Cumhuriyeti Cumhurbaşkanı Ofisi, Topluluklar için Danışma Konseyi Sekreteryası, Ofis N-321, Priştine, 10000, Kosova**

Başvuruları indirmek için lütfen Topluluklar için Danışma Konseyin internet sayfasını www.ccc-rks.net, veya aşağıdaki ueb sitelerini ziyaret ediniz:

REPUBLIKA E KOSOVËS – ZYRA E PRESIDENTIT
REPUBLIC OF KOSOVO – OFFICE OF THE PRESIDENT
REPUBLIKA KOSOVO – KANCELARIJA PREDSEDNIKA

*SEKRETARIATI I KËSHILLIT KONSULTATIV PËR KOMUNITETE*
*SEKRETARIAT OF THE CONSULTATIVE COUNCIL FOR COMMUNITIES*
*SEKRETARIAT KONSULTATIVNOG VEĆA ZA ZAJEDNICE*

Na osnovu člana 22 Statuta Konsultativnog veća za zajednice, koji je donesen putem dekreta Br. DNJ – 02 – 2017 predsednika Republike Kosovo, Sekretarijat Konsultativnog veća za zajednice

## OBJAVLJUJE JAVNO OBAVEŠTENJE

- Pozivaju se organizacije koje predstavljaju zajednice da podnesu zahtev za prijavljivanje, spisak kandidata za članove Konsultativnog veća za zajednice i spisak delegata sa pravom glasa.
- Pozivaju se lica koja pripadaju nevećinskim zajednicama na Kosovu, da se prijave pojedinačno za članove Konsultativnog veća ta zajednice.

**Poslednji rok za prijavu**:
Prijave se moraju predati u Sekretarijatu Veća do **04.07.2018. godine, u 16:00 časova.** Prijave predate nakon ovog roka neće biti prihvaćene.

**Kako da se prijavite:**
Prijave možete slati:
- Elektronskom poštom
- Fizičkom predajom ili
- Putem redovne pošte na dole navedenu adresu:

**Zgrada Skupštine, Kancelarija predsednika Republike Kosovo**

**Sekretarijat Konsultativnog veća za zajednice, kancelarija N-321, Priština, 10000, Kosovo**

Da preuzmete aplikaciju molimo vas posetite internet stranicu Konsultativnog veća za zajednice (na službenim jezicima): www.ccc-rks.net

**Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania N.T "Rahovica Comerce" Ferizaj, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, organizojnë:**

## DEBAT PUBLIK

**Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për fabrikën për prodhimin e asfaltit në Prelez i Jerlive komuna e Ferizajt.**

**Njoftohet publiku i interesuar se më datën 25.06. 2018. në ora 11:00 në hapësirat e objektit të administratës të kompanisë „ Rahovica Comerce" Prelez i Muhaxhereve, komuna e Ferizajt , do të organizohet debat publik nga Kompania N.T "Rahovica Comerce" Ferizaj, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.**

**Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për fabrikën për prodhimin e asfaltit në Prelez i Jerlive komuna e Ferizajt.**

**Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.**

**REPUBLIKA E KOSOVËS**
**REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO**
*QEVERIA –VLADA-GOVERNMENT*

*MINISTRIA BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL*
*MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE, SUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA*
*MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT*

**Agjencia Pyjore e Kosovës**
**Agencija za Šume Kosova**
**Kosovo Forest Agency**

**Sektori i Burimeve Njerëzore**
**Sektor ljudskih resursa**
**Sector Human Resources**

**Duke u bazuar në Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës NR.03/L-149, Rregulloren Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Miratimit përmes SIMBNJ të pozitës nga MAP më datën 29.03.2018/, bënë:**

## SHPALJEN E KONKURSIT PËR KËTË VEND PUNE

**Titulli i pozitës:** **Zyrtar/e i/e Personelit 2**
**Ref:** APK-06/18
**Njësia organizative:** Sektori i Burimeve Njerëzore
**Vendi i punës:** Prishtinë (1),
**Nëpunësi Mbikëqyrës:** Menaxheri/ja i/e Sektorit të Burimeve Njerëzore
**Kategoria funksionale:** Niveli profesional
**Grada e pagës (Koeficienti):** 7
**Lloji i pozitës së punës:** E KARRIERËS
**Kohëzgjatja e periudhës provuese:** Dymbëdhjetë (12) muaj

**Detyrat dhe përgjegjësit:**
- Përgatitja, sistemimi dhe mirëmbajtja e dosjeve të punësuarve –nëpunësve në APK,
- Mbajtja e evidencës së pushimeve të nëpunësve civil në APK,
- Përgatitja e raporteve periodike dhe vjetore për fushëveprimin Zyrës së Personelit dhe Zhvillimit të Burimeve Njerëzore në APK, si dhe përgatitja e formularëve të ndryshëm për nëpunës (formulari për ID,e-mail zyrtar, vërtetime për marrëdhënien dhe përvojën në punë etj,
- Përgatitja e formularëve për paga dhe kompensime, sistemimi i tyre, përfshirë edhe ndryshimet në paga dhe mbajtja e evidencave të tyre,
- Mbajtja e dosjeve disiplinore, evidencës për masat e shqiptuara nga komisioni disiplinor dhe ai i ankesave në APK-së,
- Përpunimi i të dhënave dhe nxjerrja e raporteve periodike dhe vjetore për pushime vjetore , mjekësore dhe pushime tjera për nëpunës si dhe evidencave të tyre sipas strukturës kualifikuese, etnike,gjinore , moshore, afateve të kontratave etj,
- Ndihmon udhëheqësit e njësive organizative lidhur me planifikimin e personelit,
- Kryen edhe detyra tjera në pajtim me rregulloret aktuale të cilat me arsye mund të kërkohen kohë pas kohe nga mbikëqyrësi,

**Shkathtësitë kyçe, aftësitë dhe përvoja :**

- *Së paku dy (2) vite përvojë pune ne profesion,*
- *Njohuri Profesionale specifike në fushënë burimeve njerëzore dhe trajnimeve*
- *Njohuri të Ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme për burimet njerëzore*
- *Shkathësi në Komunikim planifikim të punës koordinim eventuali personelit në nivel administrativ.*
- *Shkathtësi hulumtuese,analitike,vlerësuese dhe formulim të rekomandimevedhe këshillave profesionale*
- *Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel, Power Point, Acces)*
- *Nivel të lartë të standardit të integritetit personal, profesional dhe mbajtjes së konfidencialitetit,*
- *Të mos jetë i gjykuar për vepër penale me vendim të formës së prerë si dhe të mos ketë të iniciuar procedurë hetimore penale,*
- *Kandidatët të cilët kanë punuar ose janë aktualisht duke punuar në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës duhet të sjellin vlerësimet e punës nga udhëheqësi i drejtpërdrejtë për dy (2) vitet e fundit,*

**Kualifikimet arsimore dhe profesionale për këtë pozitë:**
*Diploma universitare e Fakultetit Juridik*

**Procedura e Konkurrimit:**
Është e hapur edhe për kandidatë jashtë shërbimit Civil të Republikës së Kosovës.

**Data e shpalljes së konkursit: 04.06.2018**
**Data e mbylljes së konkursit: 18.06.2018**

Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.
Komunitetet jo shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës qendrore dhe lokale siç specifikohet në nenin 11, paragrafin 3 të Ligjit NR.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

***Aplikacionet e pakompletuara nuk do te merren parasysh. Vetëm kandidatët që hyjnë në listën e përzgjedhur do të informohen. Dokumentet dhe dëshmitë duhet te jenë fotokopje përndryshe nuk kthehen.***
***Procedura e Aplikimit:*** *Formularët për aplikim mund të merren dhe dorëzohen në Zyrën e Personelit dhe Zhvillimit të Burimeve Njerëzore , zyra nr.2 në Agjencinë Pyjore të Kosovës, Rr. Zenel Salihu 1/A Prishtinë (pran Gjykatës Komunale apo prapa Muzeut të Kosovës).*
*Për informacione tjera shtesë kontaktoni në telefonin nr. 038-200-38-482 çdo ditë pune prej orës 8.⁰⁰ deri 16.⁰⁰.*

**REPUBLIKA E KOSOVËS**
**REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO**
*QEVERIA –VLADA-GOVERNMENT*

*MINISTRIA BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL*
*MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE, SUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA*
*MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT*

**Agjencia Pyjore e Kosovës**
**Agencija za Šume Kosova**
**Kosovo Forest Agency**

**Sektori i Burimeve Njerëzore**
**Sektor ljudskih resursa**
**Sector Human Resources**

**Na osnovu Zakona za Civilnu Službu Republike Kosova Br.03/L-149, Pravilnika Br.02/2010 za Procedure Regrutovanja u Civilnoj Službi Republike Kosova i Ovlašćenje izdato preko ISMJALJR , sa pozicije od MJA, dana 30.05.2018, Raspisuje:**

## KONKURS ZA SLEDEĆE RADNO MESTO

**Naziv pozicije:** Službenik/ca osoblja 2
**Ref:** AŠK -06/18
**Organizaciona Jedinica:** Sektor Ljudskih Resursa
**Radno mesto:** Priština
**Nadzorni Sluzbenik:** Menadžer Sektora Ljudskih Resursa
**Fubkcionalna kategorija:** Profesionalni nivo
**Nivo plate (Koeficient):** 7
**Vrsta radne pozicije:** KARIJERNE POZICIJE
**Probni vremenski period:** Dvanaest (12) meseci

**Zadaci i odgovornosti:**
- Priprema, sistamtizacija i održavanbje dosje zaposlenih-službenika u AŠK,
- Vrši evidencoju odmora civilnih službenika u AŠK,
- Priprema priodičnih i godišnjih izveštaja iz delokruga Kancelarije Osoblja i Razvoja Ljudskih Resursa u AŠK kao i priprema raznih obrazaca za službenike (obrazac za ID, službeni e-mail, potvrde za radoni odnos i radno iskustvo itd.,
- Priprema obrazaca za plate i nadoknade, njihovu sistematizaciju, obuhvateči i izmene na plate i održavanje evidencije istih,
- Održavanje disciplinskih dosijea, evidenciju za izrečenih mera od disciplinske komisije i komisjie za rešavanje spora i žalbi u AŠK,
- Razrada podataka i izrada periodičnih i godišnjih izveštaja za godišnjih odmora, bolovnja i drugih odmora za službenike kao i njihovu evidenciju po kvalifikacionoj strukturi, etniciteta, polne, starosti i rokove imenovanih akata itd,
- Pomaže rukovodiocima jedinica u vezi planiranja osoblja;
- Izvršava i ostale zadatke u skladu sa trenutnim zakonima i uredbama koje se razlogom mogu se zahtevati s vremena na vreme od strane nadzornika .

**Kljucne vestine, osposobljenost i iskustvo :**
*-Najmanje dve (2) godine radnog iskusta u profesiji,*
*-Odlična znanja u specifično profesionalnoj oblasti koja se dobijaju putem univerzitetskog obrazovanja i relevantnih treninga*
*-Poznavanje važečih zakona i uredaba*
*- Sposobnosti komuniciranja i planiranja rada, eventualno koordinisanje osoblja administrativnog osoblja*
*- Istraživačke sposobnosti, analitičke sposobnosti, sposobnosti na procenjivanju i formulisanju preporuka i profesionalnih saveta*
*- Sposobnost za rad na kompjuterskim aplikacijama i programima (Word, Excel, Power Point, Access)*
*-Visoki nivo standarda ličnog i profesionalnog integriteta i državanje konfindencije,*
*-da nije kažnjen za krivično delo sa pravosnažnom odlukom i da nije pokrenuta nikakava krivična istraga.*
*-Kandidati koji su radili ili trenutno rade u Civilnoj Službi Republike Kosova, treba da donesu za zadnje dve (2) godine vredovanje rada od strane neposrednog rukovodioca.*

**Obrazovna i stručna kvalifikacija za ovu poziciju:**
*- Univerzitetska diploma Pravnog Fakulteta.*

**Procedure Konkurisanja:**
Je otvorena i za kandidate van Civilne Kosovske Službe.

**Datum ponavljanja konkursa: 04.06.2018**
**Datum zaključenja konkursa: 18.06.2018**

Civilna Kosovka Služba pruža jednake mugučnosti zaposlenja svim državljanima Kosova i prima aplikacije svih lica muškog i ženskog pola iz svih zajednica u Kosovo.
Manjinske zajednice i njhovi pripadnici imaju prave da budu predstavljeni proporcionalno na organima Javne Službe na lokalnim i centralnom nivou ,kao što je nažnačeno i čl.11, paragraf 3 Zakona Br/03/L-149 o Civilnoj Službi Republike Kosova.

***Nekompletirane dokumentacije se neće uzeti u obzir. Biće informisani samo kandidati koji uđu u uži spisak kandidata.Dokumenti i dokazi treba biti fotokopije jer se neće vratiti.***

***Postupak konkurisanja:*** *Obrazci za konkurisanje se mogu dobiti i dostaviti Kancelarija osoblja i razvoja ljudskih resursa, kancelarija br.2 pri Agenciji za Šume Kosova, Ul. Zenel Salihu nr. 1/A Priština (iza Muzeja Kosova i pri Opštinskom Sudu u Prištini).*
*Za dodatne informacije kontaktirajte na telefon br. 038-200-38-482 svakog radnog dana od 8.⁰⁰ do 16.⁰⁰ časova.*

BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVO
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

## SHPALLJE PËR VEND TË LIRË TË PUNËS

**Titulli:** Asistent/e

**Departamenti:** Zyra e Guvernatorit

**Grada:** 8

**I raporton:** Guvernatorit

**Përmbledhje e detyrave dhe përgjegjësive:**

- Përgjegjës/e për funksionimin efikas të Zyrës së Guvernatorit;
- Mbështetje administrative, sekretarie dhe logjistike për Guvernatorin me konfidencialitet të lartë;
- Të koordinojë agjendën e Guvernatorit duke u përkujdesur për prioritetin e takimeve;
- Të kryej të gjitha funksionet e sekretarisë duke mirëmbajtur një sistem efikas, gjithëpërfshirës dhe konfidencial të dosjeve elektronike dhe atyre me shkrim që ndërlidhen me Zyrën e Guvernatorit;
- Të menaxhoj dhe të përkthej korrespondencën hyrëse dhe dalëse, interne dhe të jashtme si dhe të përpiloj korrespondencën rutinore;
- Të arkivojë dokumentet e zyrës së Guvernatorit;
- Të aranzhoj udhëtimet dhe akomodimin për Zyrën e Guvernatorit;
- Të aranzhojë agjendën dhe ndihmojë në akomodimin dhe transportin për zyrtarë të lartë të institucioneve ndërkombëtare që vizitojnë BQK-në;
- Të përkujdeset për komunikimin elektronik dhe me zë për Zyrën e Guvernatorit duke ruajtur korrespondencën relevante sipas nevojës;
- Te aranzhojë udhëtimet, akomodimin dhe çështje tjera logjistike për Kryetarin dhe anëtarët e Bordit të BQK-së;
- Njofton personelin/njësitë relevante lidhur me nevojën për veprime të përbashkëta në organizimin e ngjarjeve dhe vizitave në BQK;
- Detyra dhe përgjegjësi tjera të caktuara nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejt;

**Njohuritë e kërkuara**

- Diplomë universitare;
- Të jetë i rrjedhshëm në të folur dhe në të shkruar të gjuhës shqipe, gjuhës angleze dhe serbe;
- Njohuri të mira të punës me kompjuter;

**Përvoja e kërkuar:**

- Së paku dy vite përvojë pune bankare, në administrimin e zyrës dhe/ose në cilësinë e asistentit/ës .

**Kërkesat e posaçme:**

- Aftësi që të punoj në ekip si dhe në mënyrë të pavarur me një mbikëqyrje të vogël;
- Aftësi për të punuar në një mjedis dinamik të punës;
- Gatishmëri për të punuar me një orar të zgjatur të punës;

**Të gjithë kandidatët duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:**

- Formularin zyrtar të BQK-së për aplikim;
- Letrën përcjellëse ( motivuese) ku theksohet interesimi për këtë pozitë;
- Dëshmi mbi përvojën e punës të lëshuar nga organizata kompetente;
- Kopjet e diplomave, ndërsa diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura /nostrifikuara zyrtarisht nga ana e MASHT-it;
- Dëshmi mbi identitetin dhe vendbanimin e përhershëm në Kosovë;

**Procedura e aplikimit:**

- Afati i fundit për aplikim është 18 qershor 2018.
- Aplikimi mund të bëhet online (https:hris.bqk-kos.org) përmes faqes zyrtare të BQK-së ose përmes arkivit të BQK-së , nr.22. Asnjë formë tjetër e aplikimit nuk do të merret parasysh.
- Formën e aplikacionit mund ta shkarkoni përmes faqes zyrtare : www.bqk-kos.org
- Dokumentacionet e pakompletuara nuk do të merren parasysh.

Një vit pa ju





**Halil Kadriu** (1950 - 2017)

**Sinan Kadriu** (1954 - 2017)

Përjetësisht në mendjet dhe zemrat tona.

I përkujtojnë nxënësit dhe arsimtarët e shkollës së mesme të ulët "Ismet Uka" në Ticë - Skenderaj, në njëvjetorin e shkuarjes së tyre në amshim.

## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qira ne Fushë Kosovë, për një familje 3 anëtarësh. Banesa duhet të ketë 2 dhoma gjumi, dhomë dite, kuzhinë dhe poashtu të jetë e mobiluar. Banesa kërkohet për afat më të gjatë. Info në tel: 044-741-151

▶ Urgjentisht kërkoj banesë me qira për një çift ne Fushe Kosove. Banesa duhet te ketë një dhome gjumi dhomë dite me kuzhine te jete e mobiluar, çmimi: 150-200 euro. Tel 044-741-155

▶ Epet lokali me qira në rrugën "B" me sipërfaqe prej 214 m2. Lokali është i përshtatshëm për çfarë do lloj veprimtarie. Informatat në tel: 045-660-118.

▶ Urgjentisht kërkoj banesë me qira ne Prishtine, për një qift me një fëmijë. Banesa duhet te ketë 1 dhome gjumi dhomë dite me kuzhine. Po ashtu të jetë e mobiluar si dhe të jetë afatgjatë. Çmimi 200 euro. Tel: 044-741-155

▶ Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, trualli frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.

▶ Lëshoj me qira banesën tri dhomëshe në Bregun e Diellit, mbrapa konvikteve të studentëve, kati VI- lifti funksional, e rinovuar komplet me të gjitha elementet, e mobiluar, ka nxehje qendrore. Banesa lëshohet vetëm për familjar, për banesë duhet të lehet edhe depozitë prej një qeraje. Çmimi 350 euro, tel: 049-400-958

▶ Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, trualli frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.

▶ Agjencia për patundshmëri "SAZANI", kërkon për blerje dhe lëshojmë me qira: banesa, shtëpi, lokale, troje dhe toka. Ndërmjetësojmë me korrektësi si dhe shesim disa sosh. Numri kontaktues: 044-207-474.

▶ Shes shtëpinë në rrugën "Haxhi Zeka" afër Shkollës Teknike në Prishtinë. Çmimi sipas marrëveshjes. Tel: 049-909-641.

▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Ulpiana" afër AAK-së në Prishtinë. Për informata më të hollësishme lajmërohuni në këtë numër të telefonit: 044-162-783

▶ Kimete Lanaj B.I. kërkon një punëkryes për ndërtimin e serrës me sipërfaqe prej 40 ari, me material të zinguar. Oferta zgjat 5 ditë nga dita e shpalljes në gazetë. Kontakti: 044-528-353.

▶ Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

▶ Kërkoj kamerier me përvojë pune. Gjendemi në Prishtinë te sheshi "Zahir Pajaziti". Nr: kontaktues- 045-999-985.

▶ Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

▶ Lëshohet banesa me qira kati i parë , në rr. Esat Mekuli, çmimi i volitshëm. Për info. 044/ 477-107 Prishtinë. Çmimi shumë i volitshëm dhe është e mobiluar komplet.

▶ Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

▶ Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)


ROYAL CROWN
RC cola
ANNOUNCING THE 2017
QUALITY & SALES AWARDS
Quality & Sales Award Recipients
[Listed in alphabetical order]
★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
★ Embotelladaora Central S.A Paraguay, Quality
★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Qualtiy
★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales
RC cola
Columbus, Georgia, USA
RC cola
0.5L


AUTOSHKOLLA
"RITMO – L"
Auto Shkolla
"RITMO - L"
Prishtinë
Eksperienca jonë
- përfitimi i juaj.
Afati i paraqitjes prej 03.03.2018
deri më 10.03.2018
Ju mirëpret:
Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "
Tel / kontakt:
044 248 173
044 200 604
044 375 333